

1 E enjte, 21 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.04

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
9 çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër
10 Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Shoh që ZPS-ja ka të njëjtin ekip sikurse dje pasdite.
14 Kështu.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, kështu.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Atëherë duhet ta themi këtë thjesht për procesverbal.

18 Vërej që dhe Mbrojtësi i Viktimave ka të njëjtin ekip.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Po, kështu është.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
21 drejtohem Mbrojtjes. Ka një ndryshim që dje, kështu që po i
22 jap fjalën Avokatit të na thotë kush është i pranishëm.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Dhe mirëmëngjes.
24 Është pak a shumë në fakt e njëjta gjë. Z. Gilissen, jam me Z.
25 Aouini, znj. Cariolou, Dzeneta Petravica, menaxhere e lëndës,

1 Juliette Healy, Judit Kolbe, që janë asistente për shqyrtimin
2 e provave dhe sigurisht që z. Shala na ndjek përmes
3 videolidhjes. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
5 procesverbal, z. Shala dëgjoni mirë?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj
7 shumë mirë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Sot do të vazhdojmë me paraqitjen e provave nga Zyra e
11 Prokurorit të Specializuar. Do të bëhen kundërpjetjet e
12 Dëshmitarit numër 6 të Mbrojtjes, z. Bardhyl Mahmuti, si dhe
13 do të dëgjojmë edhe pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimave.

14 Rendi i ditës për sot do të varet nga zhvillimet. Mund të
15 jemi deri në orën 4.00, do të kemi një pushim më shkurtër të
16 drekës, megjithatë të shohim si do të eci seanca gjatë ditës.

17 Përpara se të vijojmë me dëshminë, dëshirojmë të nxjerrim
18 një urdhër me gojë sa u takon materialeve që ZPS-ja synon të
19 përdorë të përdorë me dëshmitarin e sotëm gjatë pyetjeve,
20 gjithashtu dua të flas edhe për materialet më të fundit që
21 janë nxjerrë disa minuta përpara se të vinim këtu në sallën e
22 gjyqit.

23 Së pari do të trajtojmë kërkesën e ZPS-së për 76
24 materialet dhe më pas kërkesën e djeshme për të shtuar dy
25 materiale në listën e prezantimeve dhe përkthimet e tyre

1 përkatëse.

2 Okej. Kërkesa fillestare. ZPS-ja synon të përdorë 76
3 materiale, 69 prej të cilave janë të nxjerra rishtazi, ku
4 përfshihen kategori të ndryshme dokumentesh dhe media.

5 Mbrojtja kundërshton përdorimin e katër kategorive
6 specifike të renditura në emailin e rishikuar. Që e kemi marrë
7 më 20 shtator, pra, e kemi marrë dje, në orën 2.05 të
8 pasdites. Konkretisht janë postimet në mediat sociale dhe
9 materiale që lidhen me to, dokumente që lidhen me proceset e
10 mëparshme gjyqësore, libra, artikuj dhe video. Sipas
11 Mbrojtjes, nuk ka relevancë për përdorimin e tyre.

12 Për të përdorur në mënyrë efikase kohën në Gjykatë, ne
13 morëm parashtrime nga palët përmes postës elektronike dhe tani
14 do të lëshojmë një urdhër gojor.

15 Pasi shqyrtuam me imtësi, ne konstatojmë se ZPS-ja nuk ka
16 vërtetuar lidhjen apo rëndësinë e disa dokumenteve të caktuara
17 të përfshira në listën e prezantimit, pra, nuk ka lidhje me
18 çështjen gjyqësore aktuale dhe me akuzat kundër të akuzuarit.
19 Ndërsa në disa raste ne nuk ishim në gjendje as ta vlerësonim
20 rëndësinë e këtyre materialeve, pasi nuk do t'i lejojmë. Dhe
21 ne çuam një email që të gjithë të jeni më të përgatitur. B;het
22 fjalë për materialet, po lexoj rendin siç është në listën e
23 prezantimeve. Pra, materiali numër 4, 14, 15, 16, 17, 18, 20,
24 21, 22, 30, 31, 44, 52, 53, dhe 73.

25 Sigurisht kjo nuk pengon ZPS-në që t'i kërkojë Trupit

1 Gjykues të rishqyrtojë rast pas rasti materialet në qoftë se
2 del një material i ri gjatë kundërpyetjeve. Nëse ndodh kjo, ne
3 duam që të jepni dhe argumentet pse duhet përdorur një
4 material dhe mund të bëjmë një debat gjyqësor këtu në sallën e
5 gjyqit dhe të vendosim nëse do ta përdorim ndonjë dokument të
6 caktuar.

7 ZPS-ja po ashtu kërkon leje të përdorin dy dokumente
8 shtesë, që janë dy artikuj në media në gjuhën serbe, të cilat
9 citohen si burime në librin e dëshmitarit. Janë faqet
10 konkretisht 80 dhe 81. Dhe ZPS-ja argumenton se synon t'i
11 përdorë këto dokumente për t'i bërë pyetje dëshmitarit lidhur
12 me metodologjinë që ka ndjekur kur ka shkruar librin e vetë,
13 një çështje që është diskutuar kjo dje edhe gjatë kohës që
14 pyetjet ia bënte Mbrojtja dëshmitarit. Sikurse ju thashë, kemi
15 marrë përkthimet në anglisht në mëngjes, në orën 9.05 minuta,
16 me postë elektronike.

17 Tani dua t'u jap mundësinë Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të
18 Viktimave të bëjnë parashtrimet e veta në qoftë se kanë diçka
19 përpara se të vijojmë.

20 Mbrojtja, fjala është për ju.

21 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit dhe mirëmëngjesi.

22 Të nderuar Gjykatës, ne sapo i morëm dokumentet. E vumë
23 re dhe shpjegimin që kishin bërë kolegët e ZPS-së. Nëse lidhet
24 me elementë specifik të përmendur nga pyetjet që kemi bërë ne,
25 ne nuk kemi kundërshtime. Vetëm ama në qoftë se dëshmitari ka

1 përmendur diçka dhe pala kundërshtare do ta trajtojë më tej ne
2 nuk kemi ndonjë problem. Megjithatë ne kundërshtojmë
3 përdorimin e disa materialeve të tjera sepse gjykojmë që
4 shkojmë përtej kuadrit të pyetjeve që duhet bërë në pjesën e
5 kundërpjetjeve.

6 Sidoqoftë, sikurse thashë, për dokumentet që synon të
7 përdorë ZPS-ja dhe që ju i trajtuat më tej, ne mendojmë që
8 është normale. Dëshmitari e ka shpjeguar metodologjinë. Ata
9 mund ta trajtojnë edhe më tej metodologjinë me të, megjithatë
10 duhet të mbetet tek ajo që është relevante, pra, që ka lidhje
11 me çështjen gjyqësore.

12 Çdo gjë që shkon përtej lidhjes me çështjen gjyqësore
13 mendojmë që nuk duhet trajtuar dhe duhet të kalojmë në debat
14 gjyqësor për të parë nëse duhet pranuar materiali apo jo.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Për një sqarim, për cilat materiale e kishit fjalën ju
18 kur thatë që synoni të bëni debat gjyqësor në qoftë se
19 trajtohen?

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne duam të
21 kundërshtojmë kur të përdoren materialet në listën e
22 prezantimeve, ne nuk duam të përdoren disa dokumente që
23 parimisht nuk kanë lidhje, nuk është problemi i dokumentit, po
24 mënyra sesi synon ta përdorë Prokuroria, për ne nuk është e
25 pranueshme, ka disa aspekte që nuk janë trajtuar në

1 komunikimet që kemi pasur përmes postës elektronike.

2 Pra, nëse ZPS-ja synon të përdorë disa dokumente të
3 caktuara për disa qëllime të caktuara, ne do ta kundërshtojmë.

4 Mund t'ju jap edhe shembuj konkret çfarë dua të themi.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Kur të dalin këto dokumente për
7 përdorim ne do t'i kundërshtojmë në momentin e duhur.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
9 jap një urdhër me gojë sa i takon përdorimit të këtyre
10 dokumenteve që janë tashmë në listën e prezantimeve. Pra,
11 dokumenteve që do të lejohet Prokuroria të përdorë, kështu që
12 nuk do të ketë debat gjyqësor për këto dokumente.

13 Komenti im ishte ky, nëse ka dokumente që ne nuk i
14 lejojmë dhe fillojnë të përdoren gjatë kundërpyetjeve, atëherë
15 ata mund ta argumentojnë. Dhe ju mund të kundërargumentoni.

16 Kështu do të veprojmë. Në rast se ju keni kundërshtime
17 për pyetjet, njësoj si në çdo rast tjetër, ju do të ngriheni
18 dhe do të bëni parashtrimet tuaja dhe ne do të bëjmë
19 vlerësimin tonë siç bëjmë zakonisht.

20 Në rregull. Mbrojtësi i Viktimave, a keni diçka për të
21 shtuar?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Ne nuk kundërshtojmë përdorimin e
23 dokumenteve shtesë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Vazhdojmë me urdhrin me gojë.

2 Vërejmë se ZPS-ja ka bërë të qartë se në ç'mënyrë synojmë
3 t'i përdorin këto dokumente dhe ZPS-ja i ka nxjerrë këto
4 dokumente menjëherë pasi përfunduar pyetjet e tyre dje. Gjatë
5 këtyre pyetjeve u diskutua sigurisht me dëshmitarin dhe
6 çështja e metodologjisë dhe burimeve. I morëm parasysh
7 parashtrimet e Mbrojtjes dhe të Mbrojtësit të Viktimave, i
8 cili nuk kundërshton, dokumentet nuk janë të gjata dhe janë
9 cituar si burime të librin e dëshmitarit. Me konstatojmë se
10 shtimi i tyre në listën e materialeve nuk e cenon Mbrojtjen.

11 E miratojmë, pra, kërkesën për arsyet që sapo përmenda.

12 Sa u takon materialeve të mësipërme, në lidhje me këtë që
13 sapo thashë, do i lutesha Sekretares së Gjykatës, tani të
14 ndryshojë listën e prezantimeve, mesa kuptoj unë kjo mund të
15 bëhet shumë shpejt, në qoftë se nuk e kam gabim, pra, duhet të
16 përshtatet tashmë lista e materialeve.

17 Me këtë mbyll dhe urdhrin me gojë.

18 Po kam një koment për ZPS-në sa i takon kësaj çështjeje.
19 Në të ardhmen, nëse ZPS-ja parashikon të përdorë një numër të
20 madh materialesh për kundërpvetjet e veta, ju inkurajojmë t'i
21 nxirrni dhe t'i rendisni këto materiale sapo që të keni
22 mundësi edhe për hir të palës tjetër dhe për Mbrojtësin e
23 Viktimave, po dhe për Trupin Gjykues dhe jo një ditë përpara.
24 Ne nuk duam që të nxitojmë pastaj palët, po të kenë mundësi
25 t'i shqyrtojnë edhe të bëjnë debat gjyqësor nëse është e

1 nevojshme. Ne e kuptojmë që një herë mund të ndodhë kështu, po
2 do preferonim që të mos të bëhet metodë pune kjo, sepse e bën
3 punën shumë të vështirë, e bën të ndërlikuar punën në këtë
4 formë.

5 [Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës
6 këshillohen]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
8 përfundoj me udhëzimet dhe do ndërpresim një sekondë seancën
9 por pa u larguar nga salla e gjyqit sepse një nga kolegët ka
10 probleme me kompjuterin. Është mirë që ta zgjidhim këtë, se
11 nuk ka kuptim që dikush nuk punon dot ndërkohë që ne punojmë
12 këtu në sallën e gjyqit.

13 Prandaj, siç ju thashë, ju inkurajojmë të veproni në këtë
14 mënyrë.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne do bëjmë të pamundurën për
16 t'ua plotësuar apo për t'u pajtuar me kërkesën tuaj. Por kur
17 nuk kemi deklaratat për këta dëshmitarë, është shumë e vështirë
18 për ne që t'i dorëzojmë, të përgatitemi paraprakisht dhe
19 përpiqemi të shohim bazën e të dhënave edhe shpesh kjo ndodhë,
20 puna vazhdon deri ditën që do bëjmë pyetje dëshmitarit.

21 Po të kishim deklaratat, do ishte më e lehtë për ne t'i
22 plotësonim këto kërkesa megjithatë, sikurse ju thashë, ne do
23 bëjmë të pamundurën.

24 Por ne kemi dy kërkesa sa i takon urdhrit që sapo nxorët
25 lidhur me listën tonë të prezantimeve të materialeve.

1 E para, të mos përdorni dokument që thatë që nuk duhet ta
2 përdorim. Unë i kam të renditura në planin tim. Ne e morëm
3 postën elektronike me numrat përkatëse para se të vinim në
4 sallën e gjyqit. Do ju lutesha 10 minuta ose një çerek ore të
5 shoh dhe njëherë planifikimin tim, të shoh edhe listën e
6 materialeve për të parë cilat dokumente nuk duhet të përdorim
7 sipas urdhrit tuaj. Domethënë, dua të mos përdorë dokumente pa
8 dashur që nuk duhet t'i përdorë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
10 është problem kjo. Mund ta ndërpresim seancën për një çerek
11 ore dhe ndërkohë zgjidhim edhe problemin e kompjuterit të
12 kolegut ta rindezim edhe njëherë kompjuterin. Nuk është
13 problem.

14 Po kishte dhe diçka tjetër, po administrative, lista e
15 materialeve që ZPS-ja synon të përdorë për pyetjet e veta,
16 doja t'ju thoja që herë tjetër numërtojeni, vendosini numra
17 sepse e bën punën më të lehtë.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, do ta përmirësojmë
19 metodologjinë tonë të punës.

20 Së dyti, dëgjuam që ju do të lejoni kërkesa të
21 rishqyrtohen dokumente të ngjashme gjatë kundërpyetjeve të
22 dëshmitarit.

23 Unë kam një kërkesë të rishqyrtohet një dokument, për të
24 cilin dua që ta nxjerrim jashtë dëshmitarin kur të diskutojmë
25 apo kur të bëjmë kërkesën tonë. Kërkesën mund ta bëj dhe tani,

1 sepse një dokument është me rëndësi sepse lidhet me një
2 dokument tjetër, që ju e keni lënë në listë. Kështu që unë
3 mund ta bëj tani kërkesën në mënyrë që të mos jem në një
4 situatë që ta nxjerrin dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit kur
5 të lindë nevoja për ta përdorur këtë dokument.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 këtë formë mund të veprojmë, mund të bëjmë kështu. Edhe pastaj
8 Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjnë parashtrimet
9 e veta, po tani bëjmë një shkëputje të vogël që ZPS-ja të shoh
10 edhe njëherë planin e vetë dhe ndërkohë të zgjidhim edhe - më
11 falni - pasi të bëjmë parashtrimet do të bëjmë dhe shkëputjen
12 desha thoja.

13 Z. AOUBINI: [Përkthim] Më falni që ju ndërpreva, por dua
14 t'i përgjigjem kolegut tim sa i takon kërkesës për rishqyrtim
15 të materialeve.

16 Desha të thoja nxjerrja më e fundit e materialeve nuk ka
17 lidhje fare me deklaratat apo mungesën e deklaratave të këtij
18 dëshmitari. Ne kemi dhënë një përmbledhje të saktë dhe
19 dëshmitari e ka dëshmuar pikërisht në lidhje me këtë. Kemi
20 nxjerrë dokumentet që kemi përdorur dje në seancën e
21 paradites, libri pastaj u diskutua pjesën më të madhe të
22 pasdites. Kështu që nuk mendojmë ne që mungesa e deklaratave
23 nxit përdorim e 76 dokumenteve për kundërpyetjet. Ne nuk
24 komentuar në lidhje me këtë, po na ka vendosur dhe ne tani në
25 një situatë shumë të vështirë.

1 Pika e parë.

2 Dhe pika e dytë, të nderuar Gjykatës edhe ne do
3 dëshironim të kishim mundësinë të rishqyrtohej urdhri për
4 përdorimin e disa dokumenteve. Ne besojmë se kemi edhe
5 parashtrime të tjera për të paraqitur apo të kundërpërgjigjemi
6 disa nga parashtrimeve të ZPS-së sa u takon relevancës, pra,
7 rëndësisë, po jo vetëm rëndësisë. Prandaj, ne e pranojmë që
8 ose ta bëjmë përmes pyetjeve, po ajo që kundërshtojmë ne është
9 synimi pse të përdoren prej disa dokumenteve. Disa prej
10 parashtrimeve që kanë bërë kolegët tanë për anshmëri, aleanca,
11 janë gjëra që duam të kundërpërgjigjemi, por dhe duam të kemi
12 mundësinë të na jepet dhe ne mundësia të rishqyrtohen disa
13 dokumente.

14 Nëse jeni të gatshëm të na dëgjoni tani ne mund ta bëjmë
15 që tani këtë kërkesë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i
17 takon pikës së parë, e bëtë të qartë, por edhe ne si Trup
18 Gjykues e bëmë të qartë. Ne ja bëmë shumë të qartë këtë
19 Prokurorisë. I kërkuam ZPS-së që herën tjetër të veprojë në
20 mënyrë tjetër.

21 Së dyti, nuk kuptova dhe më mungonte diçka në prezantimin
22 tuaj -- më falni. ZPS-ja ka kërkuar -- më falni, do jua jap
23 dhe një herë fjalën më vonë.

24 I drejtohem Prokurorisë, a doni të bëni një arsyetim të
25 mëtejshëm për dokumentet që doni të përdorni?

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

2 Kërkesa lidhet me një dokument ERN SPOE0020949, që besoj
3 se është numri, mban numrin 30 në listën tonë të prezantimeve.
4 Është një dokument që ka komunikatën numër 42 dhe 43 të
5 lëshuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës më 27 shkurt të 1998
6 dhe është botuar në publikimin e LPK-së, në gazetën Zëri i
7 Kosovës.

8 Të nderuar Gjykatës, tek dokumentet tona për
9 kundërpyetjet kemi renditur dhe një intervistë që dëshmitari i
10 ka dhënë gazetës Monitor më 15 prill 1998, që është gati 40
11 ditë, për afërsisht 40 ditë, pasi është nxjerrë komunikata
12 numër 42.

13 Dëshmitari, ka qenë pjesë e drejtorisë politike të UÇK-
14 së. Ka qenë i përfshirë, siç dhe do ua vërtetojmë, ka qenë i
15 përfshirë në përgatitjen, hartimin e komunikatave. Ne besojmë
16 se dëshmitari e njihte, e dinte përmbajtjen e asaj komunikate.
17 Në atë komunikatë, UÇK-ja merr përsipër përgjegjësinë për
18 vrasjen e një personi me emrin Mustafë Kurti. Ky person ishte
19 një civil. Ishte i punësuar në postën e Drenocit.

20 Tani, 40 ditë më pas, dëshmitari ka bërë deklaratë se
21 UÇK-ja shënjestronte vetëm nëpunësit shtetëror dhe ne besojmë
22 se këtë e ka bërë duke pasur njohuri, ai kishte njohuri. Për
23 ne, kjo lidhet me besueshmërinë e dëshmitarit në përgjithësi,
24 prandaj duam ta përdorim me këtë që ka thënë këtu në sallën e
25 gjyqit për të vërtetuar që ai është i anshëm në këtë proces

1 gjyqësor dhe pse ka pranuar ai të ishte dëshmitar këtu në
2 bankën e dëshmitarëve në sallën e gjyqit.

3 Prandaj ne duam të përdorim komunikatën 42 të gërshetuar
4 me artikullin që thamë që është botuar në gazetën Kristiane.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
6 mund të na thoni cilin numër ka artikulli?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë kam ERN. Nuk e kam përpara
8 tani listën e prezantimeve. A mund t'ju jap për momentin ERN?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta
10 keni parasysh që herë tjetër është mirë t'i keni të dyja.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, e kuptojmë. Dhe ju
12 kërkoj ndjesë për këtë.

13 Numri ERN është SPOE00341109-00341116. Dhe, në fakt,
14 besoj që është numri 31 në listën e materialeve ose mbase jo,
15 mbase jo. Ky është numri ERN. Dhe deklarata për të cilin po
16 flisja gjendet SPOE00341111.

17 Z. AOUBINI: [Përkthim] Besoj se materiali me numër 37 në
18 listën e prezantimeve.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 [Mikrofoni çaktivizuar]

21 Z. AOUBINI: [Përkthim] Besojmë që i përkon numrit 37 në
22 listën e prezantimeve, nëse e ndihmon ky informacion
23 Prokurorin. Në qoftë se ne nuk e kemi gabim.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
25 besoj që Prokurori mund ta verifikojë tani këtë sepse nuk e ka

1 përballë listën e materialeve, po e vlerësojmë sugjerimin
2 tuaj.

3 Në rregull atëherë. Sa i takon pikës të dytë që ngritët
4 ju, i nderuar Avokat Mbrojtës, do ta shohim si do të
5 zhvillohen kundërpyetjet, gjatë kundërpyetjeve do ta
6 trajtojmë.

7 Tani do ua jap fjalën të kundërpërgjigjeni lidhur me atë
8 që sapo tha Prokurori.

9 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë, por
10 atë sapo tha Prokuroria tani ishte pikërisht ajo që ne deshëm
11 të kundërshtonim. Synimi i ZPS-së sot është që të nxjerrë
12 dëshmi nga dëshmitari që nuk lidhen fare me çështjen tonë
13 gjyqësore. Dhe me gjithë respektin, ne këto materiale që kur i
14 morëm, ne menduam se mos ishte një gabim, mos ishte për
15 Çështjen 06, jo për ne. Sepse s'ka lidhje fare me këtë
16 dëshmitar dhe me dëshminë që ka dhënë ky dëshmitar.

17 Çështja e besueshmërisë duhet të lidhet me ato që ka
18 thënë dëshmitari këtu. Nëse duan të shohin besueshmërinë e tij
19 ku ka qenë ai, a ka qenë a s'ka qenë ai në Shqipëri, ne me
20 shumë kënaqësi do ta dëgjojmë. Por nëse duan të vërtetojnë
21 besueshmërinë e tij lidhur me ato që shkruar ai në librat e
22 veta në metodologjinë e tij dhe në këtë rast dhe e dëgjojmë,
23 është krejt normale kjo gjë.

24 Por, politika e UÇK-së nuk ka lidhje fare me çështjen
25 tonë gjyqësore. ZPS-ja ka kundërshtuar relevancën e disa

1 dëshmitarëve lidhur me brigadat. Ne nuk do flasim për këto
2 gjëra këtu. Nuk kanë lidhje fare me çështjen gjyqësore tonën
3 dhe nëse duan të paraqesin këtu prova, le ta kishin bërë
4 përmes dëshmitarëve të vetë. Kjo nuk na ndihmon ne dhe ne
5 fuqimisht e kundërshtojmë këtë mënyrë përdorimi.

6 Sa i takon argumentit të anshmërisë. Nuk është anshmëri.
7 Është mendim personal, media sociale për këtë dëshmitar. Ky
8 dëshmitar s'ka pse të jetë shok me gjykatësit apo të mos ketë
9 mendime politike për institucionet dhe për ato që kanë ndodhur
10 në mëmëdheun e tij diçka që ka pasur ndikim në mëmëdheun e
11 tij, Kosova. Ai bëri betimin, ai dha fakte konkrete.

12 Të nderuar Gjykatës, të gjithë kemi qenë këtu e dëgjuam
13 dëshmitarin. Ka ardhur këtu si individ. Ai përmendi titullin
14 dhe cilësinë e tij për të shpjeguar pse udhëtoi. Ne nuk e
15 shtjelluam më tej pse po shkonte, punën e tij, ku i kishte
16 mësuar disa gjëra. Ne e sollëm këtu për të treguar dhe të na
17 komentonte lidhur me pretendimet e dëshmitarëve të ZPS-së dhe
18 vetëm kaq.

19 Dhe i rikujtoj kolegëve të mi, të kenë parasysh rregullën
20 153 të Rregullores ku janë dhe kufijtë e kundërpyetjeve. Nuk
21 është kjo një mundësi për Prokurorinë që të zbulojnë prova të
22 reja për këtë çështje gjyqësore apo çështje të tjera
23 gjyqësore.

24 Kjo çështja kinse e anshmërisë dhe aleancës me të
25 akuzuarit e tjerë, vërejmë që është përmendur çështja Mustafa.

1 Ky dëshmitar nuk e njeh fare Pjetër Shalën. Çfarë aleance po
2 thoni ju atëherë? Do flasim për të akuzuarit e tjerë? Ne s'i
3 kemi përmendur asnjëherë, dëshmitari s'i ka përmendur
4 asnjëherë.

5 Prandaj ne fuqimisht e kundërshtojmë përdorimin e këtij
6 materiali nga ZPS-ja dhe synimin pse duan ta përdorin. Sepse
7 do të cenojë kjo integritetin e këtij procesi gjyqësor, nuk
8 mund të lejoni Prokurorinë të kalojë në fusha që janë jashtë
9 kuadrit të kundërpyetjeve.

10 Diskutuar dje për lidhjen e materialeve me këtë çështje
11 gjyqësore. I njëjti parim duhet të vlejë dhe për palët e
12 tjera.

13 Këto janë parashtrimet tona, mund të ngremë edhe pika të
14 tjera më konkrete gjatë momentit që Prokuroria do të bëjë
15 kundërpyetjet e veta material pas materiali. Por këtë
16 kundërshtim deshëm ta thonim për procesverbal dhe të
17 paralajmëronim të gjithë që as rregullorja nuk i lejon këto
18 lloj kundërpyetjesh. Nuk ka dhënë dëshmi të tilla ky dëshmitar
19 dhe nuk është nevoja që të shtjellohet më tej.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, Mbrojtës.

22 Ne fillimisht kemi thënë se sa i përket mundësitë që
23 ZPS-ja të ribatojë disa vendime meqë relevanca e disa
24 dokumenteve nuk mundej të vlerësohej tërësisht nga Trupi
25 Gjyqësor. Ju, sigurisht, si Mbrojtje, do të keni mundësinë që

1 t'i përgjigjeni debatimit të Prokurorisë. Këtu nuk ka kurrfarë
2 problemi.

3 Tani do t'ia jap fjalën Mbrojtësit të Viktimave. Do të
4 bëjmë edhe një rreth dhe pastaj do të bëjmë pushimin.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Ju faleminderit. Ne parashtrojmë
6 kështu, se çështja e besueshmërisë së dëshmitarit nuk
7 kufizohet në mënyrën sesi është përshkruar nga Mbrojtësi.
8 Domethënë, nuk kufizohet vetëm në ato tema për të cilat ai
9 dëshmitar ka dëshmuar. Besueshmëria e një dëshmitari duhet të
10 merret parasysh nga Trupi Gjykses në përgjithësi. Mbrojtja ka
11 përdorur vendime fajësie të mëparshme për të minuar
12 besueshmërinë e dëshmitarëve dhe nuk ka pasur kurrfarë
13 kundërshtimi në lidhje me këtë. Këto dënime apo vendime
14 fajësie nuk kanë pasur një relevancë të drejtpërdrejtë për
15 besueshmërinë e dëshmitarëve dhe Trupi Gjykses e din se për
16 cilin dëshmitarë e kam fjalën.

17 Dhe kjo bie ndesh me atë që po sugjeron tani Mbrojtja. Ne
18 mendojmë si vijon për këtë dëshmitar. Dëshmitari ka dhënë një
19 mendim ekstrem në lidhje me një farë lidhje që ende duhet ta
20 eksplorojmë midis një personi, një gazetari dhe kjo për
21 mendimin e dëshmitarit i jep atij të drejtë që të shprehë
22 mendimet e tij në lidhje me ngjarjet në Kukës. Kjo, për
23 mendimin tonë, i tejkalon kufijtë e një dëshmie të thjeshtë
24 dhe të sugjerosh se një dëshmitar që i ka bërë këto hapa dhe
25 ka dalë jashtë kuadrit të dëshmisë së vetë dhe që ky dëshmitar

1 nuk mund të merret në pyetje në lidhje me çështjen e
2 besnikërisë apo lojalitetit, ky është një mendim çorientues.

3 Ky është parashtrimi jonë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë shkurtimisht do të them dhe
8 nja dy-tre gjëra sepse Mbrojtësi i Viktimave e tha atë që
9 desha unë ta them. Sipas rregullores:

10 "Kundërpyetjet duhet të kufizohen brenda temave të cilat
11 trajtohen gjatë pyetjeve të palës thirrëse".

12 Nuk është fjala për besueshmëri në lidhje me çështjet që
13 i ka mbuluar dëshmitari gjatë pyetjeve të palës thirrëse. Siç
14 tha Mbrojtësi i Viktimave, çështja e besueshmërisë e mbulon
15 një gamë më të gjerë të aspekteve.

16 Çështja e besueshmërisë mund të bazohet në disa aspekte
17 siç janë, për shembull, dëshmia e penalitetit apo deklarata të
18 rreme që ka dhënë një dëshmitar dhe kështu me radhë në ndonjë
19 gjykim.

20 Ne vazhdojmë që të kërkojmë prej jush që të rishqyrtoni
21 edhe një herë vendimin tuaj në lidhje me përdorimin e këtij
22 dokumenti që përfshin Komunikatën 42.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Mendoj që i thamë të gjitha. Në qoftë se do të thoni diçka të
25 re z. Mbrojtës, po fillojmë dhe një rreth, një raund të ri

1 debatimesh.

2 Çfarë nuk është thënë?

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Dy pika. Më vjen mirë që përmendi
4 dëshminë e penalitetit por dosjen kriminale të një personi dhe
5 ky është një shembull shumë i mirë. Kjo nuk na u lejua ne ta
6 përdornim. Dhe ne atëherë kishim të bënim me disa aspekte të
7 tjera të çështjes së besueshmërisë.

8 Në lidhje me atë që thotë ZPS-ja, nuk është ky test i
9 kredibilitetit të një dëshmitari. Mirëpo është çështje për të
10 tregu sesi ky individ nuk është një dëshmitar i mirëfilltë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju po
12 e përsëritni tani vetveten. Unë ju dëgjova atë që e keni thënë
13 herën e parë, nuk ka nevojë që të përsëriteni.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk është çështje e kredibilitetit.
15 Kjo është diçka që ata e quajnë kredibilitet dëshmitari.
16 Mirëpo është një përpjekje Prokurorisë për të vënë në
17 pikëpyetje legjitimitetin e këtij personi që të jetë
18 dëshmitar.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Mbrojtësi i Viktimave.

22 Z. LAWS: [Përkthim] T'i përgjigjem shkurtimisht
23 pretendimit të Mbrojtësit se nuk është lejuar që të përdorë
24 dosjen kriminale të dikujt tjetër në të kaluarën.

25 Në mocionin e rregullës 130, së paku sa më kujtohet mua,

1 kishte referenca për këto vendime fajësie. Dhe nuk është në
2 rregull që Mbrojtja të thotë se nuk i është lejuar që të
3 përdorë ato dokumente.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Urdhëroni, Prokurori.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në sa më kujtohet, sikurse tha
7 edhe Mbrojtësi i Viktimave edhe ne nuk kemi kundërshtuar që
8 ato dokumente të paraqiten si prova apo për ato të bëhen
9 pyetje. Nuk kemi ndaluar asnjëherë Mbrojtjen që të bëjë pyetje
10 në lidhje me dosjen kriminale të ndonjë dëshmitari që ka dhënë
11 dëshmi në Gjykatë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Tani është 09.30 do të kthehemi përsëri në sallë në
14 orën 10.00.

15 --- Pauza fillon në orën 09.40

16 --- Seanca rifillon në orën 10.31

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se erdhët përsëri.

19 Kemi kuvenduar dhe kemi ndryshuar rendin e ditës. Do të
20 vazhdojmë për një orë e gjysëm tani dhe në orën 12.00 do të
21 bëjmë pushimin e drekës prej një ore.

22 Përpara se të bënim pushimin, shoh që nuk ka ndryshime në
23 përbërjen e palëve për hir të procesverbalit. Në rregull.

24 Ne, Gjykatësit, shqyrtoam pikat që u ngritën për
25 diskutim. Kemi marrë një kërkesë prej ZPS-së që të përdorë dy

1 dokumente, përkatësisht numri 30 dhe 37, që do të përdoren
2 bashkërisht. Numri 30 është në listën e prezantimeve dhe ky
3 është materiali që ne vendosëm se nuk do të lejojmë të
4 përdorej nga Prokuroria, por nga ana tjetër kemi lejuar
5 përdorimin e materialit numër 37.

6 Pasi dëgjuam argumentet e palëve dhe të Mbrojtësit të
7 Viktimave, ne mendojmë që shpjegimi i Prokurorisë përmbush
8 standardin përkatës duke marrë parasysh se në përputhje me
9 ligjin, neni 143, çështjet e besueshmërisë së një dëshmitari
10 duhet të mbahen në një shkallë më të përgjithshme. Dhe kjo nuk
11 cenon të drejtën e Mbrojtjes për të ngritur çfarëdo aspekti që
12 e çmojnë të rëndësishëm.

13 Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se rregulla 143(3) e
14 Rregullores së Procedurës dhe të Provave përcakton qartë se
15 çështje që lidhen me kredibilitetin e një dëshmitari nuk
16 kufizohen në temën e pyetjeve të palës thirrëse.

17 Së dyti, e kaluara kriminale e një dëshmitari është në
18 dispozicion të Trupit Gjykses për të marrë një vendim në fund
19 të gjykimit.

20 Pa u kthyer tani tek çështja e dëshmisë së atij
21 dëshmitari që po diskutojmë sesi kaloi ajo dëshmi, dua të
22 citoj transkriptin e datës 5 qershor, faqen 1837 deri në 1842
23 ku u diskutua çështja e pranimit ose të mospranimit të disa
24 pyetjeve që u bënë, po ta lexoni atë pjesë të transkriptit do
25 ta keni të qartë dhe ajo është e shkruar aty në atë dokumente.

1 Dhe pika e fundit për ZPS-në. Trupi Gjykues ju udhëzon që
2 radhën tjetër në qoftë se dy dokumente do të përdoren në
3 kombinim me njëri-tjetrin është e dobishme për Trupin Gjykues
4 dhe palët dhe për Mbrojtësin e Viktimave që t'i informoni. Unë
5 ndëgjova se çfarë tha në lidhje me vështirësi që mund t'i keni
6 hasur, por kjo na jep mundësi që ne paraprakisht të vlerësojmë
7 rëndësinë, relevancën e një dokument.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sigurisht që do ta bëjmë këtë,
9 e nderuar Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull. Atëherë kemi arritur një pikë ku mund ta thërrasim
12 dëshmitarin. Në qoftë se ju më nuk keni pika tjera për të
13 ngritur me Trupin Gjykues.

14 Atëherë, znj. Sekretare, sillni dëshmitarin ju lutem.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Mirëmëngjes, z. Mahmuti. Mirë se erdhët në Dhomat e
18 Specializuara.

19 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më
21 dëgjoni?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Filluam pak më vonë sesa që parashikuam për shkak të
25 disa çështjeve procedurale. Si jeni sot?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 23

1 DËSHMITARI: Mirë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Z. Mahmuti, ju ende jeni nën betimin solemn për të thënë
4 të vërtetën, E keni të qartë këtë, apo jo?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje
7 përfundam me pyetjet e Mbrojtjes, tani do t'ia jap fjalën
8 Prokurorit, Zyrës së Prokurorit të Specializuar për pyetjet e
9 tyre.

10 Vërej që Mbrojtja ka përdorur rreth dy orë për pyetjet e
11 veta dhe presim që dhe Prokurori t'i përmbahet kësaj kohe që i
12 është caktuar.

13 E keni fjalën, Prokuror.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

15 DËSHMITARI: BARDHYL MAHMUTI [Vijon]

16 Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis:

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes, z. Mahmuti. Dua të filloj me disa pyetje
19 sesi u bëtë dëshmitar për mbrojtjen e Shalës. A ju kujtohet se
20 kur u kontaktuat për herë të parë nga Mbrojtja e z. Shala?

21 PË. Saktësisht nuk më kujtohet.

22 PY. A mund të ketë qenë kjo para një muaji apo para një viti,
23 domethënë, përafërsisht kur ka qenë kjo kohë?

24 PË. Përpara një viti sigurisht nuk ka qenë. Saktësisht kur ka
25 qenë nuk më kujtohet. S'e di. Nuk më kujtohet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 24

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Dëshmitar, nuk e kuptova përgjigjen. A ka qenë para një viti
3 apo më shumë se një vit apo disa muajsh?

4 DËSHMITARI: Para disa muajsh.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull. Faleminderit.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

8 PY. Nga hera e parë që u kontaktuat, domethënë, pasi që u
9 kontaktuat nga Mbrojtja, a u takuat personalisht, sy më sy, me
10 përfaqësues të Mbrojtjes së z. Shala.

11 PË. Jam takuar personalisht një kohë shumë shkurtër për arsye
12 krejtësisht tjera që s'kanë lidhje me procesin, a dashtë të
13 ndërpres takimin se kam pasë çështje private.

14 PY. Dhe pas këtij takimi, domethënë, që u takuat
15 personalisht, a ju kujtohet se kur pas këtij kontakti të
16 shkurtër u bë kontakti i parë më i gjatë me përfaqësuesit e
17 Mbrojtjes?

18 PË. Ka qenë i vetmi kontakt fizik që kemi pasë gjatë së cilës
19 u kam dhënë librat e mi, kemi biseduar disa çështje me
20 përmbajtjen e librave të mi dhe të gjitha takimet tjera kanë
21 qenë përmes telefonatave. Me aq sa më kujtohet.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Përgjigja dallon nga pyetja, ndoshta nuk e ka kuptuar z.

24 Dëshmitar, pyetjen siç duhet.

25 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 25

1 Gjykatës. Dua ta pyes kolegun nga Prokuroria se çfarë është
2 qëllimi apo synimi i këtyre pyetjeve sepse nuk shohim ndonjë
3 relevancë, ndonjë farë lidhje me pyetjet tona.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
5 një pyetje mjaft e përgjithshme dhe e thjeshtë, domethënë,
6 sesi erdhën në kontakt dëshmitari dhe Mbrojtja.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Është me rëndësi për mënyrën
8 sesi erdhëm në kontakt me dëshmitarin, po jo që të përdoret
9 për mënyrën sesi punojmë ne.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Pyetja dallonte nga përgjigja. Pyetja për mendimin tim është e
12 ligjshme, e lejuar dhe për atë arsye dhe e ngrita këtë aspekt
13 sepse pashë që dëshmitari u përgjigj ndryshe.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi në kufi dhe do të kisha
15 preferuar që të mos shkojmë shumë larg me këtë vijë të
16 pyetjeve.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
18 rol e kemi të gjithë këtu.

19 Urdhëroni, z. Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë jam i
21 vetëdijshtëm për privilegjin e komunikimit që Mbrojtja ka me
22 klientin e vet, por do ta bëj edhe një herë pyetjen.

23 PY. Z. Mahmuti, ju na thatë se, unë të paktën e kuptova, që
24 kontakti i parë mes jush dhe Mbrojtjes ishte me anë të
25 telefonit, a është kjo e saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe sa kohë mbas këtij kontakti me anë të telefonit u
3 takuat fizikisht, personalisht, me përfaqësuesit e Mbrojtjes?

4 PË. Nuk më kujtohet.

5 PY. Po a mund t'i thoni Trupit Gjykues në qoftë se jeni
6 takuar mbas disa ditësh apo mbas disa javësh, apo mbas disa
7 muajsh?

8 PË. Këto aspekte teknike nuk çuan aspak peshë në mënyrën sesi
9 unë funksionoj prandaj dhe nuk i mbaj mend.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem përpiguni që t'i përgjigjeni pyetjes. Ju na thatë që
12 kontakti i parë ndodhi mbas disa muajsh. Dhe në qoftë se nuk
13 jeni duke thënë se keni probleme me kujtesën atëherë mund të
14 na jepni një kohë të përafërt se kur ka ndodhë ky kontakt, a
15 ka qenë mbas një muaji, apo mbas një jave e kështu me radhë,
16 z. Dëshmitar.

17 Prandaj të lus që t'i përgjigjeni pyetjes së Prokurorit.
18 Nuk bëhet fjalë, domethënë, a ka qenë një ditë apo dy ditë më
19 pak apo më shumë, unë po ju pyes thjesht përafërsisht sa kohë.

20 DËSHMITARI: Nuk kam kurrfarë problemi me kujtesën. Por
21 mbaj mend ato që më kanë interesuar. Nuk po më kujtohet kur
22 është bërë telefonata dhe sa kohë pas telefonatës jemi taku.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

24 PY. Në rregull, atëherë do të vazhdoj me pyetje tjera.

25 Përpara kontaktit të parë, pra, do të pyes një herë -- më

1 falni një pyetje shtesë, në lidhje me kontaktin e parë që keni
2 pasë me Mbrojtjen a ishte Mbrojtja ajo që ju ka kontaktu juve
3 apo ju e kontaktuat Mbrojtjen?

4 PË. Më ka kontaktuar Mbrojtja, se unë as nuk e kam ditë se
5 kush është në Ekipin e Mbrojtjes së z. Pjetër Shala.

6 PY. Në kohën që ju kontaktuan, domethënë, në kohën kur ju
7 kontaktuan me telefon, a e dinit se për akuzat që kishte
8 ngritur Zyra e Prokurorit të Specializuar kundër z. Shala, a i
9 dinit, a ishit të vetëdijshëm për akuzat?

10 PË. Kam qenë në njohuri për aq sa kam njoftuar mediat.

11 PY. Domethënë, a keni qenë në dijeni, me fjalë tjera, çfarë
12 informacioni keni pasë në dispozicion në atë kohë, çfarë dinit
13 ju në lidhje me akuzat kundër z. Shala?

14 PË. Lidhur me akuzat e ngritura kundër Pjetër Shalës kam
15 mësuar nga mediat në mënyrë të përgjithësuar dhe asnjëherë nuk
16 kam hy në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të
17 hulumtoj çka konkretisht.

18 PY. Pas takimit të parë me Mbrojtjen, domethënë, pas
19 kontaktit të parë me telefon, a u përpoqët të merrnit më shumë
20 informacion në lidhje me këtë çështje gjyqësore, pra, për
21 çfarë bëhet fjalë në këtë çështje gjyqësore?

22 PË. Meqenëse në kontaktin e parë kemi biseduar lidhur me
23 përmbajtjen e librit tim, nuk kam hy të hulumtoj më gjerësisht
24 lidhur me akuzat që janë bë kundër Pjetër Shalës.

25 PY. Po Mbrojtja a nuk ju dha një farë përmbledhje të kësaj

1 çështje gjyqësore gjatë takimit apo kontaktit që patët apo në
2 një moment të mëvonshëm?

3 PË. Me Mbrojtjen kemi biseduar vetëm lidhur me përmbajtjen e
4 librit tim, asnjë element që lidhet me dosjen e Pjetër Shalës
5 nuk është diskutuar në takim me mua. Çdo gjë që kanë kërkuar
6 të sqarojnë lidhur me rrugëtimin tim politik ua kam thënë pa e
7 ditur arsyen se për çfarë arsye u duhen ato të dhëna.

8 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po ndërpres
9 Prokurorin. Po tani po e diskutojmë përmbajtjet e takimeve të
10 dëshmitarit me Ekipin e Mbrojtjes.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
12 herën tjetër mjafton të kërkonit t'ua jap fjalën dhe unë do
13 t'jua jap fjalën. Kjo i lehtëson edhe shkëmbimet apo jo?

14 Çfarë qëndrimi keni ju, Prokuror?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë nuk po kërkoj informacion
16 që është brenda kufijve të informacionit të privilegjuar midis
17 klientit dhe mbrojtësit, thjesht dua që të di nga dëshmitari
18 në qoftë se e ka diskutuar natyrën në përgjithësi të kësaj
19 çështjeje.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk është kjo çështje apo
21 argumentim i Mbrojtjes. Sepse nuk jemi ata që po akuzohemi.
22 Nuk është ky argumenti apo çështja e Mbrojtjes sepse ne nuk
23 jemi duke u akuzuar. Ata po flasin për mënyrat që i kemi
24 përdorë ne për ta kryer punën tonë dhe hetimet tona. Në lidhje
25 me dëshmitarin, unë nuk kam kurrfarë problemi. Dhe unë e

1 konsideroj këtë çështje të marrëdhënies së privilegjuar klient
2 Mbrojtës. Edhe kur mund të bësh lirisht disa pyetje në lidhje
3 me punën që kemi bërë ne me dëshmitarin, kjo nuk mund të
4 lidhet me çështjen e privilegjit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Mendoj që mund të bëhet pyetja se çfarë dëshmitari di rreth
7 çështjes gjyqësore dhe mendoj kjo mjafton. Dhe ka një kufi dhe
8 po i afrohem atij kufiri shumë shpejt.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kam të qartë.
10 PY. Na thatë që ky takim ishte i shkurtër. A ju kujtohet
11 afërsisht sa zgjati ky takimi i parë përpara se ju duheshit të
12 largoheshit për arsye private për të cilat unë, sigurisht, që
13 nuk do t'ju pyes?

14 PË. Nuk besoj se të ketë kaluar më shumë se 30 minuta. Dhe
15 kam kërkuar falje. Sepse ata kanë bërë gjithë rrugëtim të
16 takohemi. Mu më ka ndodhë gjëra që më është dashtë në mënyrë
17 imperative të shkoj gjetiu dhe gjithë takimi ka qenë rreth
18 gjysëm ore. Nëse nuk gabohe, nuk e di. E di që ka qenë verë e
19 vitit të kaluar. Saktësisht nuk më kujtohet data, po janë
20 çështje që nuk i kam memorizuar sepse nuk e kam rëndësinë.
21 Sikur ta kisha parë rëndësinë që të memorizoj edhe datat e
22 takimit, sigurisht, këtu do t'ju kisha thënë të vërtetën
23 saktësisht me datat që jemi takuar.

24 PY. A u morën deklaratë juve gjatë atij takimi, a dhatë ju
25 deklaratë?

1 PË. Gjatë atij takimi kemi biseduar rreth përmbajtjes së
2 librit dhe sidomos shtyllave në të cilat jam mbështetur për të
3 argumentuar funksionimin e shërbimit sekret të Serbisë.
4 Çështjet kanë qenë të fokusuara këtu, të sigurohen që të
5 gjitha burimet që kam shfrytëzuar në këto raste janë burime të
6 besueshme. Ajo që më kujtohet. Gjëra tjera nuk më kujtohen.
7 Nuk kam nënshkruar asnjë deklaratë në atë kohë, me sa e mbaj
8 mend se nuk ka pasë, domethënë, asgjë të nënshkruhet, kemi
9 bisedu tema të kësaj natyre.

10 PY. Dhe një pyetje të fundit lidhur me këtë. A mbante dikush
11 shënime gjatë atij takimi?

12 PË. Nuk më kujtohet. Kanë qenë dy përfaqësues të Mbrojtjes.
13 Nuk më kujtohet që të kenë mbajtur dikush shënime. Ka qenë më
14 shumë bisedë, me sa ka mund ta përceptoj unë, mes
15 intelektualësh që kanë dashtë dinë atë që e kam thënë në
16 libër, a është e vërtetë dhe a mund të dëshmohet.

17 PY. Faleminderit. Na thatë që në kohën kur u takuat me
18 Mbrojtjen nuk ishit në dijeni të natyrës së çështjes kundër të
19 akuzuarit. Prej atij takimi e deri dje kur erdhët për të dhënë
20 dëshmi a patët mundësinë që të njoftoheni me natyrën e kësaj
21 çështjeje gjyqësore nëpërmjet dokumenteve që janë publikisht
22 të disponueshme?

23 PË. Ju garantoj edhe pse jam në betim se asnjë dosje që
24 lidhet me të gjitha dosjet e Prokurorisë Speciale, nuk e kam
25 lexuar. Për të njëjtën arsye, sepse kur i lexoj të gjitha

1 shpifjet që bëhen në akuzat e publikuara në media, më
2 shkaktojnë një nervozë të madhe sepse e di që janë të
3 pavërteta. Dhe pikërisht për këtë arsye nuk kam dashtë t'i
4 studioj më hollësisht. Kam ardhë këtu pa paragjykime. Kam
5 ardhë këtu të dëshmoj për ato që di, për tërë atë që di dhe
6 vetëm për atë që di.

7 PY. Në rregull. Z. Mahmuti, dje gjatë dëshmisë suaj --

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Avokat Mbrojtës keni fjalën.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po ju ndërpres.

11 Duam për të hir për procesverbalin, të theksojmë se kolegët
12 nga Prokuroria po përpiqen që të hedhin një farë hije mbi
13 etikën e punës që bëjmë edhe pse e thamë të kundërtën, pra, se
14 nuk do ta bëjnë këtë me dëshmitarin.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A do
16 t'i përgjigjeni këtij kundërshtimi apo doni të vazhdoni me
17 dëshmitarin.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të vazhdoj me dëshmitarin.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Vazhdoni atëherë.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua të shtoj vetëm që Mbrojtja
22 nuk është ajo që jep dëshmi në këtë çështje. Ne dëshmitë i
23 marrim nga dëshmitarët dhe do të vazhdoj.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
25 do t'ju jap juve Mbrojtësit që të përgjigjeni,

1 kundërpërgjigjeni.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Shkurtimisht.

3 Ne nuk jemi dakord. Kemi bërë prezantimet e tona. Kemi
4 thënë se nuk kemi marrë deklarata dhe nuk kemi marrë shënime
5 dhe kjo është shumë e qartë. Tani po bën pyetje që sjellin në
6 pyetje sjelljen e pahijshme. Ata duhet të bëjnë qartë çështjen
7 e vet përpara se t'i bëjnë dëshmitarit pyetje.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të vazhdoj, të nderuar
9 Gjykatës.

10 PY. Dëshmitar, ju thatë që gjatë luftës nuk e keni njohur z.
11 Pjetër Shala dhe kjo është në transkriptin e dëshmisë së
12 djeshme. A është kjo e saktë?

13 PË. Është tërësisht e saktë. Po ju jap vetëm një shembull
14 znj. Gjyqtare, nëse më lejohet. Në nëntor --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
16 z. Dëshmitar. Faleminderit, që ofroni mundësinë për të dhënë
17 një shembull, por do t'ia lë Prokurorit që të vendosë se cilin
18 aspekt don ta trajtojë më gjatë.

19 Vazhdoni, z. Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, a kishit mundësinë që të takonit apo të
22 njoftoheshit me z. Pjetër Shala pas luftës?

23 PË. Unë nuk jam takuar asnjëherë me Pjetër Shalën as para
24 luftës, as gjatë luftës, as pas përfundimit të luftës.

25 Në nëntor të vitit 2021, kam bërë vizitë në Hagë, kam

1 vizituar të burgosurit që janë. Kam bërë kërkesë për njerëzit
2 që i kam njohur. Gjatë asaj vizite, nuk kam bërë kërkesë për
3 Pjetër Shalën sepse nuk kam pasë shka të bisedoj me një njeri
4 të cilin nuk e kam njohur. Për të vetmen arsye, kjo çështje që
5 po e them këtu --

6 PY. Në rregull. Ju kuptoj. Ju faleminderit. Tash kjo më lidh
7 me njerëzit që deshët t'i takoni në Njësinë e Paraburgimit.

8 Ju thatë që nuk e keni të njohur aktakuzën në këtë
9 çështje gjyqësore. Po e keni të njohur, a keni njohuri për
10 aktakuzën publike të ngritur kundër z. Thaçi, z. Veseli, z.
11 Krasniqi dhe z. Selimi? A jeni në njohuri të atyre aktakuzave?

12 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
13 Gjykatës, nuk kemi të qartë çfarë lidhje ka kjo pyetje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
15 pyes Prokurorin të na thotë pse.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me kënaqësi, por për këtë duhet
17 t'i kërkojmë dëshmitarit të dalë nga salla e gjyqit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 fakt këtë po mendoja dhe unë.

20 Sekretare, shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës së
21 gjyqit.

22 Z. Dëshmitar, për një çast do dilni jashtë sallës së
23 gjyqit.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

1 mund ta bëjmë në seancë publike apo në seancë private?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

3 Dëshmitari, sikurse do ta shihni më vonë gjatë
4 kundërpyetjeve, do t'i tregojmë disa deklaratat nëpërmes
5 postimeve në Facebook, pra, ky dëshmitar ka bërë deklaratat
6 shumë konkrete dhe të forta lidhur me faktin që çështjet në
7 këtë Gjykatë janë fabrikime nga ana e serbëve, që kjo Gjykatë
8 është politike. Deklarata të tilla janë dhe më befasuese kur
9 vijnë nga dikush që pretendon që as i ka lexuar aktakuzat apo
10 që nuk ka dijeni për dokumentet që lëshon kjo Gjykatë.

11 Unë besoj se Trupi Gjykues do të jetë në gjendje të
12 vlerësojë deklaratat, postimet në Facebook që ka bërë ky
13 person për të vlerësuar sa njohuri ka ai për këtë çështje
14 gjyqësore. Se një gjë është të thuash që e di dhe tjetër gjë
15 të thuash jo unë e shpërfill komplet dhe nuk më intereson.

16 Këtu këtë dua të vërtetoj unë, kjo është rëndësia e kësaj
17 pyetjeje.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk pajtohem
21 fare, nuk është fare nuk ka asnjë lloj rëndësie kjo. Këto
22 deklaratat, sikurse thamë, janë opinione personale, komente
23 personale që një person ka bërë në sferën private në media, në
24 median sociale. Nëse Prokurori është befasuar, le ta pyesë
25 tani që është nën betim. Po nuk ka pse të jetë befasues është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 35

1 mendim personal. Nuk është e bazuar në ndonjë hulumtim kjo
2 gjë. Ndërsa ne eksploruar një libër që ai ka shkruar, kishte
3 dhe burime libri. Dhe ta kemi të qartë s'është Çështja 06.

4 Znj. Cariolou, do shtoj diçka në lidhje me këtë.

5 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Dua të shtoj që mendimet
6 politike të dëshmitarit apo mendime të tjera nuk kanë rëndësi
7 për çështjen tonë. Dhe ne e kundërshtojmë dhe i qëndrojmë
8 kundërshtimit tonë që ne paraqitëm me shkrim sa i takon
9 relevancës për zbulimin e këtyre provave gjatë kundërpvetjeve
10 nga ana e Prokurorisë.

11 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
13 lejojmë pyetjen, mendojmë që është me rëndësi.

14 Sekretare, ju lutem sillni dëshmitarin sërish në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se u kthyet. Mirë se u kthyet. Po ia jap edhe njëherë fjalën
18 Prokurorit.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

20 PY. Pra, thamë, ju vetë thatë që nuk i njihnit aktakuzat apo
21 dokumentet publike që ka lëshuar kjo Gjykatë.

22 Përpara se të vinit këtu mbase më 18 shtator, por nuk jam
23 i sigurtë për datën, a keni publikuar në median sociale,
24 mediat tuaj sociale, faktin që po vinit për të dhënë dëshmi në
25 çështjen kundër Pjetër Shalës, keni postuar në median tuaj

1 sociale lidhur me këtë?

2 PË. Po. Kam postuar për të shmangur çdo përpjekje që
3 gazetarët të më kontaktojnë qoftë përmes telefonit apo
4 rrjeteve sociale. Në postimin që e kam bërë mund ta konstatooni
5 që është një njoftim objektiv pa gjykuar asgjë lidhur as me
6 procesin, as me personat.

7 PY. Shumë mirë. Pas publikimit tuaj, ju kontaktoj njeri pasi
8 bëtë këtë publikim ju kontaktoj njeri të diskutoni dëshminë
9 tuaj për këtë çështje gjyqësore me përjashtim të Mbrojtjes së
10 Shalës?

11 PË. Pas publikimit nuk më ka kontaktuar as Mbrojtja e z.
12 Pjetër Shala dhe askush tjetër sepse nuk kam dashur të
13 komunikoj me askënd. Nga Mbrojtja e z. Pjetër Shala kam qenë
14 në dijeni se gjatë gjithë këtij procesi të dëshmisë sime nuk
15 kemi të drejtë të komunikojmë pos disa çasteve kur jemi takuar
16 në kuadër të kësaj ndërtese disa sekonda jo më tepër.

17 PY. E qartë. Nuk desha të thoja që keni kontaktuar, thjesht e
18 kisha për ta pyetur?

19 PË. Pyetja ishte e nënkuptueshme që lënë të kuptohet se gjoja
20 Mbrojtja e z. Shala më ka kontaktuar. Pyetja ishte e tillë së
21 paku e përkthyer se pos Mbrojtjes së z. Shala a u ka
22 kontaktuar. Kjo në mënyrë implicite nënkupton se Mbrojtja më
23 ka kontaktuar. Prandaj mu dashtë të them që Mbrojtja nuk më ka
24 kontaktuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Mahmuti, mbase s'është kuptuar sepse, siç e kuptuam ne dhe
2 mund ta lexojmë edhe një herë pyetjen. Nuk implikojë gjë, nuk
3 nënkuptojë gjë. Ishte një pyetje, pra, ideja ishte që keni
4 postuar diçka në median sociale. Dhe ai ju pyeti, a ju ka
5 kontaktuar njeri, jo domosdoshmërisht Mbrojtja, a ju ka
6 kontaktuar njeri?

7 Mbase humbi diçka në përkthim, nuk e dimë. Por kjo ishte
8 pyetja për procesverbal.

9 DËSHMITARI: Në përkthim ka qenë pyetja që linte të
10 nënkuptohej se përveç, tekstualisht e them çka është, përveç
11 Mbrojtjes së z. Shala, a ju ka kontaktuar dikush? Prandaj unë
12 dhashë këtë sqarim sepse ajo linte të nënkuptohej se Mbrojtja
13 më ka kontaktuar.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
15 është nevoja ta përsërisni, e dëgjova. Mjafton. E dëgjova
16 shumë mirë. Ju thashë edhe një herë, si ishte në transkript.

17 Vazhdoni, Prokuror.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Z. Mahmuti, dje dhatë dëshmi sa i takon rolit tuaj në
20 vitin 1998 dhe në 1999. Kam disa pyetje në lidhje me këtë.

21 Dje në faqen 2486 të transkriptit, është e reflektuar
22 kjo, ju thatë që përpara luftës ju keni qenë anëtar i LPK-së
23 që është Lëvizja Popullore e Kosovës, kështu?

24 PË. Përpara luftës dhe gjatë luftës. Gjatë luftës kam pasë dy
25 funksione: Anëtar kryesie i LPK-së dhe përfaqësues politik i

1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2 PY. Faleminderit për sqarimin. E vlerësojmë.

3 A e njihni një tabloid që është Zëri i Kosovës?

4 PY. Po.

5 PY. Kjo gazetë a kishte ndonjë lidhje në ndonjë formë me LPK-
6 në a kishte ndonjë farë afilimi me LPK-në?

7 PË. Zëri i Kosovës ka qenë e vetmja gazetë që tërësisht ka
8 qenë e përkushtuar në mbrojtjen politike të Ushtrisë
9 Çlirimtare të Kosovës. Shpirtnisht ka qenë gazeta ime. Jam
10 identifikuar me shkrimet e asaj gazete.

11 PY. Pra, i njihni shkrimet që nxirrte Zëri i Kosovës në vitin
12 1998 dhe 1999 gjatë luftës, kështu?

13 PË. Një numër shkrimesh, jo të gjitha, për arsye se
14 vazhdimisht kam qenë në udhëtime, në kontakte goftë në
15 cilësinë e përfaqësuesit politik të UÇK-së, goftë në cilësinë
16 e anëtarit të kryesisë së LPK-së. Prandaj dinamika e luftës që
17 është zhvilluar në Kosovë më ka pamundësuar të lexoj çdo
18 shkrim të asaj gazete dhe mund të them se ndoshta dinamika ka
19 qenë e tillë që më ka imponu mbi 90 për qind të shkrimeve të
20 mos i lexoj.

21 PY. Faleminderit. Dje, në faqen 2487 të transkriptit, ju
22 thatë nëse duhet të gjenit datën kur u kyçët në UÇK dhe thonit
23 që mund të kishte qenë qershori 1998, kështu?

24 PË. Nga momenti kur unë jam ba përfaqësues politik, të
25 përfaqësoj politikisht UÇK-në në rrafshin diplomatik me

1 delegacionet amerikane të njëpasnjëshme është qershori i vitit
2 1998. Ndërsa kjo nuk do të thotë se jam kyç në UÇK në këtë
3 datë sepse LPK-ja - që nuk m'u la dje të sqaroj - ka qenë
4 pikërisht organizata politike që e ka kriju dhe e ka
5 mbështetur UÇK-në.

6 PY. Faleminderit. E kuptova dëshminë tuaj dje. Thjesht ju
7 thatë dje që "Nëse do më duhej të jepja një datë do thoja që
8 ka qenë qershori i 1998".

9 Dhe sot përsëritët që roli juaj ka qenë roli i një
10 përfaqësuesi politik. A keni pasur ndonjë emërim publik në
11 këtë pozitë?

12 PË. Po. Është deklarata politike e gushtit 1998, që bënë
13 publik gjashtë përfaqësuesit politik të Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës. Nëse nuk gaboju është Deklarata numër 7.

15 PY. Jo, të drejtë keni, nuk e keni gabim. Kush ju emëroi në
16 këtë rol?

17 PË. Nuk e di çfarë rëndësie ka për procesin. Nëse është e
18 domosdoshme do të përgjigjem edhe në këtë pyetje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
20 sa kohë unë s'e ndaloj pyetjen, ju udhëzojmë që të
21 përgjigjeni.

22 DËSHMITARI: Janë dy intervista të Xhavit Halitit, i cili
23 është njëri nga ata gjashtë personat.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 PY. Zotëri. Do flasim dhe për anëtarët e grupit. Unë vetëm

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 40

1 kaq dua të di, kush ju emëroi në këtë pozitë? Nëse doni të
2 bëni të jepni pak kontekst, mund ta jepni, po ju lutem
3 fokusohuni tek përgjigja.

4 PË. Isha tërësisht i fokusuar në përgjigje. Në dy intervistat
5 që ka dhënë Xhavit Haliti si përfaqësues politik i UÇK-së,
6 tregon se ai më ka autorizuar mua që të takohem në emër të
7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me delegacionet amerikane.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Mendoj që transkripti nuk po thotë ato që dëgjuam ne nga z.
10 Dëshmitar, nuk po reflekton taman çfarë tha z. Dëshmitar. Më
11 lini ta shoh një çast. "Në dy intervistat që ka dhënë si" --
12 kush ishte përfaqësuesi i UÇK-së, z. Mahmuti, në këtë fjali?

13 DËSHMITARI: Gjithashtu kam qenë përfaqësues i politik i
14 Ushtrisë çlirimtare të Kosovës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë. Faleminderit. U sqarua. U sqarua. Besoj se e kuptoni dhe
17 kur flas pak anglisht.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 PY. Emërimi juaj nuk u deklarua nga Shtabi i Përgjithshëm i
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

21 PË. Është një komunikatë që, nuk më kujtohet saktësisht, e
22 cila që thotë që Bardhyl Mahmuti është takuar me përfaqësues
23 diplomatikë të jashtëm pa hyrë në detaje, po ai nuk është një
24 emërim zyrtar. Emërimi zyrtar është deklarata politike e
25 gushtit të vitit 1998, ku saktësohet se Bardhyl Mahmuti është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 41

1 në mesin e atyre gjashtë përfaqësuesve politik të Ushtrisë
2 Çlirimtare të Kosovës.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ta sqarojmë këtë pikë. Dhe për
4 të sqaruar këtë le të shohim komunikatën për të cilën po fletë
5 z. Mahmuti, Komunikatën numër 7.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rregull.

8 Sekretare.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po i jap numrin ERN se nuk kam
10 numrin e listës së prezantimeve, nuk e kam të përditësuar më.
11 versioni anglisht është U000-8992-U000-8992.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo
13 shumë shpejt. Jo, shumë shpejt.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Me ET, pra,
15 ERN U000-8992-U000-8992 versioni origjinal. Anglishtja mbaron
16 me ET në fund.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Vazhdoni. Po shihja stenografen.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Presim që të shfaqet dokumenti
20 në ekran.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
22 priste lejen time Sekretarja, ndërkohë që po komunikoj pak me
23 stenografen.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 PY. Z. Mahmuti, e shihni dokumentin në ekran? Nuk është

1 cilësia shumë e mirë por të paktën është i lexueshëm besoj.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
3 lexoni dot? Mundeni?

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Besoj se në paragrafin e tretë, rreshti i tretë, ku
6 thuhet:

7 "Shtabi i Përgjithshëm bën publik se Jakup Krasniqi,
8 Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Hashim Thaçi, Faton Mehmetaj
9 dhe Sokol Bashota janë përfaqësuesit politikë të UÇK-së".

10 Në fund të komunikatës, në fund të kësaj deklaratë jepet
11 data dhe thuhet pastaj:

12 "Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".
13 Në fund fare.

14 Dhe unë po ju pyes formalisht kush ju emëroi në këtë rol
15 a nuk ishte Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës?

17 PË. Këtu hyjmë në një fushë ku më duhet shumë ma shumë kohë
18 të argumentoj sepse nuk është një përgjigje binare me "po" ose
19 "jo" që mund të ndriçojë këtë aspekt. Këtu duhet të bëhet një
20 dallim thelbësor në atë që kemi dashur të shfaqim publikisht
21 para botës se jemi një strukturë e organizuar dhe realiteti
22 historik nëpër të cilën kemi kaluar. Nëse dëshironi një
23 përgjigje rreth kësaj, do më lejoni të flas, të më lejoni të
24 flas gjerësisht rreth dimensionit.

25 PY. Jo, nuk është nevoja. Më falni. Nuk na duhet përgjigje

1 shumë e thelluar. Ne po themi këtë thotë dokumenti. Është
2 nxjerrë në emër, është e shkruar e zeza mbi të bardhë, është
3 nxjerrë në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. A
4 pajtoheni me mua?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Avokat.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po përpiqem të kuptoj lidhjen, ç
8 lidhje ka Çështja 06 me çështjen Shala. Mënyra sesi ka
9 funksionuar, sesi është organizuar UÇK-ja s'ka lidhje me ne,
10 s'ka lidhje me çështjen e z. Shala.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
12 dhe unë përgjigje për këtë po fillimisht po ia jap fjalën
13 Prokurorit.

14 Pyetja ju lutem çfarë lidhje ka kjo pyetje, çfarë
15 rëndësie ka kjo pyetje? Po përpara se të përgjigjeni keni
16 parasysh që këtu është dëshmitari.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më vjen keq po besoj se
18 dëshmitari duhet të largohet një çast nga salla e gjyqit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Dëshmitar edhe njëherë do të duhet të dilni nga salla e
21 gjyqit.

22 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
24 ju, z. Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për të gjetur themelësinë,

1 atëherë dua të bëj të qartë çfarë rëndësie ka pasur, çfarë
2 pozicioni ka pasur dëshmitari në UÇK, me cilët persona të
3 tjerë ka qenë i emëruar, cili është organi prej të cilit
4 buronte autoriteti i tij. Këto janë të rëndësishme për të
5 vlerësuar deklaratat që me shpresë do t'i marrim më vonë sa i
6 takon njohurisë së tij apo njohurisë së pretenduar të tij
7 lidhur me veprimtari të caktuara të UÇK-së. Këto janë të
8 rëndësishme për besueshmërinë e dëshmitarit.

9 Krahas kësaj, vërtetë çështja jonë nuk është Çështja 06
10 siç e thoni, por krimet e kryera janë pjesë e kryer në atë
11 çështje gjyqësore kanë lidhje me politikën e gjerë të UÇK-së
12 edhe sigurisht që NKP-ja në Çështjen 6 është formuluar
13 ndryshe. Por ama ka lidhje dhe me çështjen tonë, krahas
14 fakteve ne duam të shohim, të vërtetojmë besueshmërinë e
15 dëshmitarit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Avokat. Shoh që të dy doni të çoheni, shoh që jeni të dy
19 për t'u çuar. Aouini vazhdoni, fjala është për ju.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

21 Sapo dëgjuam kolegun tonë me argumentin e vetë. Në qoftë
22 se nuk po japim dëshmi këtu për Çështjen 6, ç'a po bëjmë ne
23 këtu, politika? Ndonëse është formuluar ndryshe NKP-ja,
24 Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët. Ne ju paralajmëruam për
25 këtë, qysh në fillim të diskutimit sot paradite. Thamë ky

1 është një ushtrim për të minuar kredibilitetin dhe për të
2 nxjerrë dëshmi për Çështjen 6. Në qoftë se duan të bëjnë këtë
3 gjë le të vijjnë avoketërit e Çështjes 6 le ti përfaqësojnë ata
4 klientët e tyre për të gjitha gjërat që po thuhet këtu.
5 Dëshmitari konkretisht e tha, specifikisht e tha: Ky është një
6 dokument, unë mund të përgjigjem, po do më jepni kohë që të
7 përgjigjem se do kem përgjigjen të gjatë t'u shpjegojë
8 realitetin.

9 Ne s'jemi këtu për të përfaqësuar ata, të akuzuarit e
10 tjerë. Kjo dhe njëherë e theksoj, kjo nuk është çështje
11 besueshmërie. Le të shikojmë postimin e tij, mendimet e tij
12 politike, çdo gjë tjetër që ka thënë ai. Ata po përpiqen të
13 nxjerrin këtu politikën, strukturën që shkon përtej asaj që
14 mund të ketë ndodhur në Kukës. Çdo gjë këtu. Kjo nuk është
15 normale.

16 Ju lutem të mbrojmë integritetin e këtij procesi
17 gjyqësor. Nuk duhet të ndodhë në këtë mënyrë. Me gjithë
18 respektin që kam.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
20 dhe ju mund të flisni pastaj do ia jap fjalën Prokurorit.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pajtohem me Prokurorin, do të
22 kuptojë çfarë pozite ka pasur dëshmitari brenda UÇK-së. Pjesa
23 tjetër, ata po peshkojnë për informacione. Po përpiqen të
24 nxjerrin informacione për Çështjen 06. Nuk është nevoja për
25 këtë. Dhe një herë po ju kërkoj: Çfarë lidhje kemi këtu?

1 Dje vendosët - dhe e respektova vendimin tuaj - ju thatë
2 që duhet të gjejmë lidhjen mes informacionit që ne duam të
3 dëgjojmë dhe ta përdorim dhe Çështjes 04.

4 Po tani po shohim tjetër gjë. Ne nuk jemi këtu që të
5 nxjerrin informacione që nuk kanë lidhje fare me z. Shala, me
6 çështjen e z. Shala. E tha dhe z. Aouini, nuk po përpiqen të
7 shohin besueshmërinë këtu. Jo. Është pikërisht unë e thashë
8 fjalën po këmbëngul tek fjala po peshkojnë informacion.

9 Nuk e vlerësoj sulmi që po i bëhet Mbrojtjes.

10 Isha gati të largohesha nga seanca madje. Mjaft. Ka një
11 kufi. U mbush kupa. Jemi profesionistë këtu. Ne nuk jemi
12 kriminelë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Askush nuk e tha këtë gjë, z. Gilissen, askush nuk ju akuzoi
15 për një gjë të tillë.

16 Z. Prokuror, nëse mendoni se është e nevojshme do ju jap
17 edhe një herë fjalën për të diskutuar, për t'u
18 kundërpërgjigjur. Përndryshe do them dhe unë diçka.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është besueshmëria. Pozita që
20 ka pasë ky dëshmitar, personat me të cilët ka punuar dhe ka
21 bashkëpunuar janë shumë të rëndësishme për të vërtetuar
22 saktësinë apo vërtetësinë e disa deklaratave që ka dhënë ai.

23 Për ne është e qartë që ky dëshmitar është i njëanshëm në
24 këtë institucion dhe kjo njëanshmëri buron për shkak të
25 pozitës që ka pasur dhe aleancave që ka pasur gjatë luftës.

1 Për ne kjo është relevanca, lidhja.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
3 nuk e lejoj më shumë. E kuptova shumë qartë qëndrimin tuaj,
4 Mbrojtja.

5 Do t'ua them këtë për procesverbal, nuk do të bëjmë debat
6 gjyqësor tani për Çështjen 6. Absolutisht jo. Dhe nuk shoh
7 fare të jetë ky synimi. Nga komentet tuaja, besoj se kuptohet
8 që ZPS-ja tani e ka të qartë, e dëgjoj këtë prej jush. Në
9 qoftë se kjo ndodhë dhe hyjmë në një debat gjyqësor për
10 Çështjen 06, Trupi Gjykes prandaj është këtu të mos e lejojë.

11 Shpjegimi që sapo na dha, sa i takon pyetjeve që kemi
12 dëgjuar deri tani, pra, pozitën që ka pasë ky person në UÇK,
13 mendoj se janë relevante për pyetjet vijuese dhe ne kemi
14 pranuar dy dokumente në fillim të seancës në lidhje me këtë.
15 Prandaj unë do t'i lejojë pyetjet dhe nuk më duhet të jap çdo
16 herë një shpjegim të gjatë a do e lejojë apo s'do e lejojë një
17 pyetje. Tani mu duk e nevojshme. Megjithatë e kam parasysh
18 paralajmërimin që na bëtë. Edhe ne këtu kemi detyrën tonë. Po
19 për momentin nuk mendoj që kishte kaluar ndonjë kufi ndonjë
20 prej palëve.

21 Sekretare, sillnin dëshmitarin edhe njëherë në sallën e
22 gjyqit.

23 Ndërkohë, Prokuror, ju lutem përdorni numrat ERN, mund
24 t'ju referoheni dokumenteve përmes numrave ERN.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Dëshmitar, faleminderit dhe faleminderit për durimin. Kështu
3 është puna duhet të dilni herë pas here nga salla e gjyqit dhe
4 kërkoheni në kuptimin tuaj në lidhje me këtë.

5 Po ia jap edhe njëherë fjalën Prokurorit.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, do të përsëris pyetjen. A pajtohemi që ky
8 dokument shkruan e zeza në të bardhë që është lëshuar në emër
9 të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?
10 PË. Ajo që dikujt mund t'i duket si e zezë mbi bardhën se
11 është e shënuar Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës dhe realitetit që nuk do --

13 PY. Nuk na intereson kjo gjë nuk është ky thelbi. Ne duam të
14 dimë këtë kjo ka dalë, ky dokument ka dalë në emër të Shtabit
15 të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kjo na
16 intereson, a ka dalë në emër të Ushtri Çlirimtare të Kosovës,
17 Shtabit të Përgjithshëm - më falni?

18 PË. Deshta të sqaroj që ne kemi pasë dëshirë të funksionojmë
19 dhe më mirë se çdo shtet i NATO-s, realiteti nuk mund të
20 përfshihet as në të gjitha ngjyrat e ylberit dhe jo më një
21 ngjyrë zi e bardhë që i dukej dikuj. Realisht çka kemi
22 proklamuar për t'u paraqitur si palë serioze në të gjitha
23 takimet diplomatike dhe realitetit në terren janë dy gjëra që
24 ndoshta janë diametralisht shumë larg njëra tjetrës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

1 fal, z. Prokuror.

2 Dëshmitar, humba pak në këtë përgjigjen tuaj. Dua thjesht
3 të kem një përgjigje të qartë prej jush. Dhe do t'ua japim
4 fjalën në qoftë se duhet ta elaboroni më andej në qoftë se e
5 shihni të nevojshme që të e shpjegoni.

6 Unë në letër, pra, në këtë dokument që kemi përpara e
7 shoh që shkruan "Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare
8 të Kosovës". Domethënë, duket që dokumenti është nxjerrë nga
9 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

10 Dhe ju dëgjova që thatë "bardh e zi", "realiteti", e
11 kështu me radhë. Nuk dua një elaborim të mjegullt. Çfarë doni
12 të thoni? Dhe në dukje ju thoni që nuk ka qenë Shtabi i
13 Përgjithshëm ai që e ka nxjerrë këtë komunikatë? Në qoftë se
14 është kjo që ju mendoni atëherë e thoni. Thjesht nuk dua që të
15 humbim kohë.

16 Çfarë doni të thoni? Unë nuk do t'ju ndërpres në qoftë se
17 do të elaboroni dhe doni të sqaroni më tej, po thjesht nuk du
18 mendim të mjegullt.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Në transkript shkuan "fake" që
20 është "e rreme" por "e mjegullt" duhet të jetë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit për sqarimin.

23 DËSHMITARI: Sqaroj se në funksion të bindjes së palëve
24 diplomatike, ne kemi vu emrin e një organi Shtab i
25 Përgjithshëm, për të krijuar përshtypjen se jemi strukturë e

1 organizuar në një komandë. Realiteti është krejt tjetër.
2 Prandaj e përdora atë që dikuj mund t'i duket si e zeza mbi të
3 bardhë në realitet është ba në funksion të propagandës se
4 vërtetë jemi partner seriozë në të cilin duhet të llogaritet
5 në zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani do t'ia jap fjalën Prokurorit
8 sepse është ai që i bën pyetjet, por do t'ju kërkoja që në të
9 ardhmen, në vend se të flasim sikur jemi duke dhënë ndonjë
10 ligjëratë do t'ju kisha lutur që të përqendrohemi në pyetje.
11 Në qoftë se kemi nevojë për informacion shtesë ne vetë do
12 t'jua kërkojmë atë informacion.

13 Vazhdoni, z. Prokuror.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
15 PY. Jemi ende tek roli juaj si përfaqësues politik, dje gjatë
16 dëshmisë na thatë se në këtë rol ju keni udhëtuar në vendet
17 perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara për të mbajtur kontakte
18 diplomatike me qëllim legjitimimin e UÇK-së dhe luftës së UÇK-
19 së. Dhe kjo është në faqen 2488 të transkriptit të djeshëm. A
20 është kjo e saktë?

21 PË. Plotësisht e saktë.

22 PY. Atëherë a do të ishte e saktë të thuhet se ju keni vepruar
23 si një lloj zëdhënësi i UÇK-së jashtë Kosovës, domethënë, si
24 një zëdhënës i jashtëm për UÇK-në?

25 PË. Jo. Nëse ka nevojë dua ta sqaroj pse jo. T'jua sqaroj pse

1 jo.

2 Zëdhënësi tregon se çka ka bë dikush tjetër. Zëdhënësi i
3 qeverisë tregon për punët e qeverisë. Zëdhënësi ka dhe rolin e
4 spikerit. Unë kam qenë ai në mesin e të cilëve është mundu
5 politikisht ta arsyetojë që lufta e popullit shqiptar është e
6 drejtë dhe se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është duke
7 zhvilluar një luftë të drejtë çlirimtare. Dallon ndërmjet asaj
8 zëdhënësit edhe përfaqësuesit politik.

9 PY. Po ju pyes sepse kështu ju ka përkufizuar z. Jakup
10 Krasniqi në një proces tjetër para Tribunalit të Hagës për
11 ish-Jugosllavinë. Ai aty ka deklaruar se:

12 "Zëdhënësi i UÇK-së për Kosovën ishte ai, kurse për
13 pjesën e jashtë vendit për publikimin e politikës së UÇK-së
14 ishte Bardhyl Mamuti".

15 A pajtoheni me këtë deklaratë të tij?

16 PË. Deklarata që e kemi në ekran bie ndesh me atë çka kanë
17 mendu të përkthejnë përkthyesit me një dëshmi të z. Jakup
18 Krasniqi në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-
19 Jugosllavinë. Unë kam qenë vetëm përfaqësues politik i
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një zëdhënës ka qenë. Ka qenë
21 Jakup Krasniqi zëdhënës dhe në të njëjtën kohë përfaqësues
22 politik i ushtrisë çlirimtare të Kosovës. Deklarata politike
23 këtu dëshmon që i pari nga njerëzit që përmendët këtu është
24 Jakup Krasniqi si përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të
25 Kosovës.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
2 të lakojmë në një temë tjetër mendoj unë.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

4 PY. Dëshmitar, na thatë që keni udhëtuar jashtë vendit me
5 synimin për të mbledhë mbështetje dhe për ta çuar përpara
6 kauzën e UÇK-së. Përveç kësaj a keni diskutuar edhe për
7 çështje tjera me pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
9 mund ta bëni të ditur se mbi çfarë baze e bëni këtë pyetje
10 sepse unë nuk e kam të qartë se ku doni të dilni për atë dhe
11 ju kërkoj këtë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do ta rifomuloj pyetjen dhe
13 ndoshta do ta keni më të qartë.

14 PY. Dëshmitar, a keni diskutuar, për shembull, çështje që
15 lidheshin me kapjen dhe lirimin e të burgosurve të luftës në
16 kapacitetin tuaj, në cilësinë tuaj si përfaqësues politik i
17 UÇK-së?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni
19 fjalën Mbrojtës.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Po përsëritemi. Çfarë lidhje ka kjo
21 me çështjen e fajësisë apo pafajësisë së z. Shala? Nuk është
22 roli i tij me të cilin ka diskutuar apo jo. E ka pasaportin.
23 Mund të shohim se çfarë ka ndodhë. Mirëpo kjo që po bëhet këtu
24 është në lidhje me Çështjen 06. Jo me çështjen tonë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Vazhdoni, z. Prokuror.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Kjo lidhet me çështjen e kredibilitetit të dëshmitarit
5 dhe këtë mund ta diskutojmë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Atëherë do ta nxjerrim dëshmitarin nga salla, mund të na jepni
8 një farë sqarimi dhe mund të vazhdojmë.

9 Dëshmitar, ju faleminderit për durimin. Do t'ju largojmë
10 pak nga salla për një kohë të shkurtër.

11 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni
13 fjalën, z. Prokuror.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dëshmitari mohon që të ketë
15 pasë kontakte me civilë. Ne kemi një dokument dhe mendoj që
16 duhet të hyjmë në seancë private për këtë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] të
18 kalojmë në seancë private, ju lutem.

19 Z. AOUBINI: [Përkthim] A mund të na jepet numri, një
20 referencë nga transkripti për këtë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
22 ju dëgjova.

23 Z. AOUBINI: [Përkthim] Prokurori po thotë se dëshmitari
24 mohon çështjen e kontaktit me civilë. A mund të na japë numrin
25 e faqes së transkriptit ku dëshmitari e ka thënë këtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 54

1 Për çfarë çështje besueshmërisë bëhet fjalë?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
3 mund ta riformuloni pyetjen z. Aouini, ju lutem, nuk e kam të
4 qartë atë që po e thoni për momentin.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Transkripti nuk është i plotë. Për
6 atë arsye dhe kam probleme.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 [Mikrofoni çaktivizuar]

9 Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva, Mbrojtës. Por nuk mund
10 të vazhdojmë diskutimet ndërkohë që po kalojmë në seancë
11 private. Duhet të presim pak.

12 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F744

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Domethënë, kemi dy çështje për të diskutuar sqarimin e
17 mëtejshëm nga Prokurori dhe u ngrit një çështje në lidhje me
18 transkriptin që duhej të zgjidhej.

19 E keni fjalën, Mbrojtës.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Kur Prokurori filloi të shpjegonte
21 qëndrimin e vetë në faqen 50, rreshtat 13, të këtij
22 transkripti, nuk është transkriptuar çdo gjë. Prokurori thotë
23 që dëshmitari, ky dëshmitar ka mohuar disa fakte në lidhje me
24 disa civilë.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do t'i përdorim disa dokumente

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 55

1 me këtë dëshmitar, të cilat do të përdoren si bazë për pyetjet
2 që do t'ia bëjmë atij në lidhje me këtë gjykatë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
4 ka debatim të mëtejshëm në lidhje me këtë. Në qoftë se e thoni
5 që nuk është i plotë transkripti. A ju kuptova drejtë apo jo?

6 Z. AOUMINI: [Përkthim] Thjesht ju shpjegova sepse nuk mund
7 ta citoj Prokurorin plotësisht sepse ajo pjesë nuk është e
8 transkriptume plotësisht në transkript në faqen 50. Dhe
9 thjesht unë i kërkova Prokurorit që të na japë numrin e
10 rreshtit apo të faqes së transkriptit të dëshmisë së këtij
11 dëshmitari ku është ajo pjesë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
13 është nga transkripti, po nga dokumentet. Dhe ajo që po ndodh
14 tani është se ZPS-ja po i bën gjërat hap pas hapi për të
15 paraqitur bazën mbi të cilat do të mbështeten pyetjet e saj,
16 domethënë, nuk dëshiron që të kalojë menjëherë në atë pikë
17 sepse Trupi Gjykes ose Mbrojtja mund të thotë se nga ka dalë
18 kjo pyetje? Unë kështu të paktën e kuptova mënyrën sesi do t'ia
19 bëjë pyetjet Prokuroria. Dhe e gjithë kjo që lidhet me
20 standardin e besueshmërisë së këtij dëshmitari dhe jo me
21 qëllimin e përcaktimit të fakteve për Çështjen 06.

22 A ju kam kuptuar drejtë, z. Prokuror?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Së pari, do ta pyes dëshmitarin
24 në qoftë se ka pasur ndonjë rol tjetër në aktivitetet e tij,
25 për shembull, do ta pyes në qoftë se ka negociuar lirimin e të

1 burgosurve, se ne kemi prova që e ka bërë këtë.

[Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 lidhje me dokumentin që momentalisht është i përjashtuar nga
21 lista e prezantimeve, kjo nuk do të thotë që ai nuk është i
22 pranuar në qoftë se doni ta përdorni ju mund së pari ta
23 diskutoni atë.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë mund ta përdorë për t'i
25 vënë përpara dëshmitarit dokumentin dhe për parë sesi do të

1 përgjigjet ai në lidhje me të.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
3 mirë njëherë duhet ta diskutojmë këtë.

4 Në rregull. A mund, ju lutem, të sillni në sallë
5 dëshmitarin?

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Dëshmitar, mirë se erdhët përsëri.

9 Do t'i jap fjalën Prokurorit.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 PY. Z. Dëshmitar, a keni diskutuar ndonjëherë me komunitetet
12 ndërkombëtarë në lidhje me ndalimin dhe lirimimin e të
13 burgosurve të luftës nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
14 a jeni angazhuar në diskutime të tilla?

15 PË. Të burgosur të luftës nuk është term adekuat nëse është
16 përkthi. Kemi biseduar lidhur me ushtarët e zënë rob në Shalë
17 të Bajgorës, në atë kohë kur janë zënë dhe është bë publike,
18 se gjashtë apo shtatë ushtarë, nuk më kujtohet saktësisht,
19 janë zënë rob nga UÇK-ja. Diplomata amerikane kanë kontaktuar
20 me mua dhe në atë kohë, domethënë, kemi biseduar sesi të bëhet
21 lirimi i tyre. Dhe si përfundim i kësaj --

22 PY. Faleminderit. Faleminderit Tani përveç kësaj, a keni
23 diskutuar ndonjëherë me pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar
24 arrestimin nga ana e UÇK-së të civilëve shqiptarë të Kosovës?

25 PË. Për shkak të propagandës serbe që është bë, janë shtruar

1 edhe pyetje të kësaj natyre, po përgjigja ka qenë kategorike
2 se nuk ka të burgosun nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të
3 Kosovës.

4 PY. Deklarata juaj që, domethënë, ju deklaroni se Ushtria
5 Çlirimtare e Kosovës asnjëherë nuk ka ndaluar civilë, kjo
6 është deklarata juaj?

7 PË. Në çfarë kuptimi përdoret termi "ndalim"? Më intereson,
8 domethënë, çka nënkupton me "ndalim"

9 PY. Kuptimin e përgjithshëm që do të thotë kur dikujt i
10 mohohet liria personale, i privohet liria.

11 PË. Për këto çështje nuk më kujtohet që kam diskutuar me
12 diplomatë të huaj. Në atë kohë nuk kam mbajtur asnjë shënim,
13 ditar, rreth takimeve diplomatike pos atyre komunikatave
14 publike që i kam nënshkruar vetë. Janë një numër komunikimesh
15 në kuadër të grupit diplomatik që janë shkruar dhe në asnjë
16 komunikatë të nënshkruar prej meje kur kam bërë publike
17 përmbajtjen e bisedimeve që kam pasë me diplomatë të shteteve
18 perëndimore në asnjë rast nuk është përmendur që temë diskutimi
19 kanë qenë të ndaluar në kuptimin e të arrestuar nga Ushtria
20 Çlirimtare e Kosovës.

21 PY. Ti marrim një nga një gjërat, z. Mahmuti, ju nuk ju
22 përgjigjët pyetjes time. Unë ju pyeta a është qëndrimi juaj se
23 UÇK-ja asnjëherë nuk ka ndaluar civilë. Ju mu përgjigjët duke
24 pyetur se çfarë doja të thoja me fjalën të ndaluar apo ndalim
25 dhe nuk ju përgjigjët pyetjes time.

1 A është qëndrimi juaj se UÇK-ja asnjëherë nuk ka ndaluar
2 civilë brenda kuptimit që njihet përgjithësisht të kësaj
3 fjale?

4 PË. Ne dijeni në time dhe sa më kujtohet mua jo.

5 PY. Pra, a është dëshmia juaj që edhe sot e kësaj dite ju nuk
6 keni dijeni për civilë që të jenë ndaluar nga anëtarë të
7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? A është kjo dëshmia juaj?

8 PË. Edhe sot e kësaj dite mbështes qëndrimin se çdo gjë që
9 kam dorëzuar komisionet e përgatitura nga shërbimi sekret i
10 Serbisë në krye me Milovan Dreçun dhe i ka dorëzuar qoftë
11 Prokurorisë së Gjykatës Penale për Ish-Jugosllavinë, qoftë
12 Prokurorisë Speciale, janë sajesa të cilat kanë për qëllim të
13 diskreditojnë pastërtinë e luftës çlirimtare. Çdo gjë që vjen
14 nga ky komision, i cili me mburrje deklaron se e kanë mësu
15 Prokurorinë çfarë drejtimi të bëjnë hetimet, unë nuk i besoj
16 edhe asnjëherë nuk kam biseduar me miqtë e mi rreth kësaj
17 çështjeje.

18 PY. Në rregull. Faleminderit. Do të ndërlihem dhe më vonë
19 me këtë përgjigjen por për momentin dua që të kalojmë në një
20 seancë private se dua t'i paraqes dëshmitarit një dokument në
21 lidhje me ndërveprimin personal të tij me pjesëtarë të
22 komunitetit ndërkombëtarë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
24 do ta diskutojmë më tej në seancë private.

25 Kemi dhe pesë minuta deri në pushimi e drekës. Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar
në bazë të F744

Page 61

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

1 rregull.

2 Znj. Sekretare, të kalojmë në seancë private.

3 Z. Shala nuk po na ndjek më me videolink.

4 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F744

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Shala, po do t'jua japim fjalën. Nuk ju dëgjoj.

8 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Kam nevojë vetëm një

9 minutë deri në tualet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

11 po. Sigurisht që mund të shkoni, z. Shala.

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka

14 problem.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] A mund të na japë Prokurori numrin

16 e dokumentit në mënyrë që dhe ne mund ta ndjekim.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sigurisht që po. Numri i

18 dokumentit është -- vetëm ta kontrolloj edhe një herë për t'ua

19 dhënë numrin e saktë. 075522 deri 075551.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ky është i njëjti

21 dokument që e diskutuam pak më përpara, është numri 4 dhe 5,

22 mendoj, në listën e prezantimeve.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse

24 e kam kuptuar drejt, është numri 4, materiali 4? Atëherë nuk

25 mund ta mbajmë dëshmitarin këtu në sallë në lidhje me atë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar
në bazë të F744

Faqe 62

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

1 çështje, meqë jemi afër në kohën e pushimit të drekës do të
2 kalojmë në seancë publike. Do ta nxjerrim dëshmitarin nga
3 salla dhe do ta bëjmë pushimin të gjithë dhe pastaj pas
4 pushimit mund të kalojmë në seancë private për të ndëgjuar
5 shkëmbimet nga palët në lidhje me këtë dokument. Shpjegimet
6 dhe informacionet që mund të vijnë nga palët dhe Mbrojtësi i
7 Viktimave dhe kështu do të kisha dash që të vazhdojmë.

8 Z. Shala, e shoh që u kthyet.

9 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju falënderoj.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
11 ka problem.

12 Znj. Sekretare, a mund të na ktheni përsëri në seancë
13 publike.

14 ~~{Seancë e hapur}~~

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit, Sekretare.

18 Atëherë do të bëjmë pushimin, z. Dëshmitar, sikurse e
19 thashë dhe në seancë private, por po e përsërisë për njerëzit
20 që nuk janë në sallë të gjyqit por në galerinë për publikun
21 apo dikund tjetër. Do të bëjmë pushim të drekës deri në ora
22 1.00. Ju uroj drekë të këndshme dhe shihemi atëherë.

23 Faleminderit.

24 DËSHMITARI: Gjithashtu ju dëshiroj një drekë të këndshme.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
2 do t'ua jap fjalën akoma z. Prokuror po presim z. Shala.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndoshta dhe z. Shala kuptojë që
4 po bëjmë pushimin.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
6 jo. S'besoj. U kthyet z. Shala. Nuk duam që të humbim
7 kontaktin me ju.

8 I akuzuari: [Përmes videolidhjes] Kërkoj falje. Unë
9 mendova se do bëjmë pushimin. Kërkoj falje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
11 nuk keni faj. Mbase unë s'isha e qartë. Dhe pesë minuta.

12 Duhet të kalojmë në seancë private për të dilutuar këtë
13 pjesë.

14 Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Prokuror, kishte diçka që mbeti për kohën që ju nevojitet
24 për kundërpyetjet.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po kjo varet sa ndërprerje do

1 kem gjatë pyetjeve të mia. Ju e bëtë të qartë që çështjet
2 lidhur me kredibilitetin, besueshmërinë, mund të eksplorohen
3 me dëshmitarin. Avokati vazhdon të ngrihet gjatë gjithë kohës
4 dhe thonë që kjo s'ka lidhje me çështjen gjyqësore. Ne po
5 eksplorojmë besueshmërinë, a është i vërtetë dëshmitari, a
6 janë të vërteta deklaratat e veta, a thotë të vërtetën kur
7 thotë di këtë gjë apo nuk di këtë gjë. Nëse ne nuk ndërpritemi
8 vazhdimisht, besoj se duam dhe një orë, një orë, një orë e
9 gjysëm. Po kjo vetëm në qoftë se na lejojnë të vazhdojmë pa
10 ndërprerje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. Faleminderit.

13 Duhet të kemi një plan B gjithmonë për menaxhimin e
14 zhvillimit gjyqësor. Kështu që i ftoj të gjitha palët e
15 pranishme të kenë parasysh që nuk është e sigurtë po të shihni
16 një mundësi për javën tjetër për të - e enjten pasdite dhe të
17 premtën, të mërkurën më falni. Dhe një herë të mërkurën
18 pasdite dhe të premtën. Po të shohim si do shkojë dita e
19 sotme, pra, të mërkurën dhe të premtën.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Para se të shohim agjendën tonë, unë
21 dhe bashkëmbrojtësja jemi në udhëtim atë ditë, duhet të
22 takojmë viktimën në fund të seancës ditën e mërkurë dhe
23 kthehem vetëm ditën e diel.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Okej.
25 Atëhere plani B s'funksionon. Na duhet një plan C.

1 Ka gjë tjetër që doni shtroni me Trupi Gjykues?

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Dua të flas diçka për këto
3 ndërhyrjet, ne po bëjmë punën tonë. Nuk është as për ndonjë
4 qejf i madh të çohemi gjithë kohën në këmbë, të paktën unë,
5 nuk më pëlqen ulu-ngrihu gjatë gjithë kohës. Unë po bëj punën,
6 dua të më jepet mundësia. Nuk mendoj se kemi bërë ndërhyrje të
7 paligjshme. As nuk kemi për synim këtë gjë, të parregullta, as
8 s'e kemi këtë synim. Ne po përpiqemi ta bëjmë të qartë që nuk
9 po përpiqem të vërtetojë besueshmërinë, po shkon përtej asaj
10 që ne duhet të pranojmë sa i takon besueshmërisë.

11 Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Atëherë po e përsëris edhe një herë unë se Trupi Gjykues deri
14 tani ka treguar që nuk ju ka kufizuar ju të shtroni të gjitha
15 pikëpyetjet tuaj lidhur me ato që diskutohen në këtë sallë
16 gjyqi. Ju e bëtë të qartë pikën tuaj, po nuk është nevoja ta
17 vini në dyshim dhe se po ju them unë, ne nuk po ju pengojmë të
18 merrni fjalën, as nuk po themi që keni qejf të çoheni e të
19 uleni gjatë kohës, e kuptojmë që doni të bëni parashtrimet
20 tuaja.

21 Ju lutem, ta lemë këtu? Ta lemë këtu.

22 Atëherë kthehemi në orën 1.10.

23 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.10

24 -- Seanca rifillon në orën 13.12

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se u kthyet. Shohim që Prokuroria është me të njëjtët
2 pjesëmarrës.

3 Mbrojtësi i Viktimave po ashtu.

4 Shoh dhe nga Mbrojtja që po pohon me kokë që do të thotë
5 që ne mund të vazhdojmë tani.

6 Trupi Gjykses do të japë një urdhër me gojë sa i takon
7 materialit 4 në listën e prezantimeve të ZPS-së. Ne do ta
8 pranojmë materialin sepse nëse mendojmë që ka relevancë sa i
9 takon besueshmërisë. Është një pjesë shumë e kufizuar, edhe ne
10 gjykuam që është relevante për pyetje të mëtejshme.

11 Sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit, ju lutem.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
14 Mahmuti, mirë se u kthyet. A më dëgjoni?

15 DËSHMITARI: Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Shala, ju dëgjoni?

18 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Tani do t'ia jap sërish fjalën Prokurorisë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë
23 private për këtë pjesë të pyetjeve të mia, ju lutem?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Patjetër. Dhe kur të kalojmë në seancë private na thoni dhe

1 arsyen pse duhet të kalonim në seancë private.

2 Sekretare, kalojmë në seancë private, ju lutem.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 75

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 76

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 77

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 78

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 79

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 80

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 81

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 82

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F744*
6 PY. Më herët, diskutuam Zërin e Kosovës, gazetën Zëri i
7 Kosovës, dhe sot në dëshminë tuaj, faqja 56 e transkriptit jo
8 përfundimtar, na thatë se ju vetë kishit nënshkruar disa
9 komunikata që ishin nxjerrë në emër të Ushtrisë Çlirimtare të
10 Kosovës, a është kjo e saktë?

11 PË. Unë kam thënë një gjë të tillë? Asnjëherë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më lejoni vetëm të kthehem pak
13 më mbas. Ndoshta --

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
15 çaktivizuar]

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është faqja 56, duke filluar
17 nga rreshti 9 i transkriptit.

18 "Në atë kohë nuk kam mbajtur shënime tek takimet
19 diplomatike me përjashtim të komunikatave publike që i kam
20 nënshkruar vetë. Ka disa komunikata brenda grupit diplomatik
21 që u bënë publike..."

22 Dhe unë e bazova pyetjen time në këtë pjesë të
23 transkriptit. A mund të na shpjegoni, ju lutem?

24 PË. Kërkoj të korrigjohet dhe të bëhet ajo si e kam thënë unë
25 saktësisht. Njoftime, *information*, kam ba, komunikata nuk ka
lëshuar grupi --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur)

Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 84

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni, dëshmitar. Ndoshta
2 jemi ende në seancë private?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
4 çaktivizuar]

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sa për mendimin tim mund të
6 kalojmë edhe jashtë seancës private, të dalim në seancë
7 publike sepse nuk kam më pyetje në lidhje me këtë dokument.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
9 është mirë që të kthehemi në seancë publike.

10 Mund të kthehemi në seancë publike, ju lutem?

11 ~~{Seancë e hapur}~~

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Nuk ka përkthim]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit që na kthyet në seancë publike.

15 Vazhdoni z. Prokuror.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

17 PY. Po e përsëris pyetjen. Nga ajo që kuptova nga transkripti
18 i përkohshëm del që keni qenë -- më falni -- që i keni hartu
19 ju disa komunikata të UÇK-së, dhe unë tani po ju pyes në qoftë
20 se ju në fakt keni qenë autor i ndonjë komunikate politike apo
21 deklarate politike në emër të UÇK-së?

22 PË. Është bërë përkthim i gabuar. Unë kam qenë si përfaqësues i
23 grupit diplomatik, nënshkrues dhe përpiliues i njoftimeve për
24 takimet që ka pasë grupi diplomatik me diplomatët e huaj.

25 Asnjë komunikatë, asnjë deklaratë, në emër të Ushtrisë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 85

1 Çlirimtare të Kosovës, nuk e ka shkruar dhe përpiluar Bardhyl
2 Mahmuti.

3 PY. Atëherë, do t'ju paraqes një postim që e keni bë në
4 Facebook dhe dua që ta diskutoj me ju atë postim në mënyrë që
5 të kuptojmë më mirë rolin tuaj në hartimin e atyre
6 komunikatave.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund
8 t'ia tregojmë dokumentin dëshmitarit? Është dokument me numër
9 SPOE00301736 --

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Vendosni në ekran këtë dokument, ju lutem.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] -- vazhdon numri i faqes deri
13 në SPOE00301754. Dhe numri i ERN-së është 301073 [sipas
14 përkthimit].

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund t'ju ndihmoj ndoshta me numrin
16 e dokumentit në listën e prezantimeve. Është materiali numër
17 12, dhe 13.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mendoj që e kemi në ekran këtë material, por gjithsesi
20 faleminderit për ndihmën.

21 Më informuan se numri ERN është burimi më i besueshëm për
22 dokumentin, edhe pse në urdhrin tonë gojor të sotshëm kemi
23 dhënë numrin e dokumenteve sipas radhitjes së tyre në listën e
24 prezantimeve. Mirëpo mund të ketë ndonjë ndryshim.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

1 PY. Z. Mahmuti, ky postim ka të bëjë me një reagim tuajin
2 ndaj dikujt që ju ka akuzuar se keni qenë autor i komunikatës
3 politike numër 59, është z. Gani Geci. Dhe ju në atë postim e
4 hidhni poshtë atë akuzë, e mohoni. Megjithatë, në atë postim
5 në Facebook dhe po lexoj nga përkthimi, dhe ju e -- po citoj:
6 "Në atë kohë, i kam qartësu komunikatën nëpërmjet të cilave
7 Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte deklaruar një armëpushim për
8 t'i dhënë mundësi Kosovës -- që çështja e Kosovës të zgjidhej
9 me anë të dialogut."

10 Pyetja ime është: Nga ky postim i juaji, e kuptoj që ju
11 të paktën e keni diktuar këtë komunikatë nëpërmjet telefonit?
12 A e keni bërë këtë ose jo?

13 PË. Përkthimi është tërësisht i pasaktë. Kërkoj që Gjykatës
14 t'i jepet tekstualisht çka është shkruar në faqen time të
15 Facebook-ut dhe në -- të shihni sesi është manipuluar
16 deklarata ime. Nuk është e vërtetë.

17 Në selinë e NATO-s në prezencë të Clark, Richard
18 Holbrooke dhe Larry Rossin, është përpiluar komunikata për
19 armëpushim pas bisedimeve që kanë qenë në Beograd, Holbrooke
20 në vizitë. Atë komunikatë nuk e kam shkruar unë, e kanë
21 përpiluar autoritet që kanë qenë të pranishme. Ka diktuar
22 Richard Holbrooke, ka shkruar Larry Rossin.

23 Unë nuk kam pranuar ta qes një komunikatë në emër të UÇK-
24 së nga Brukseli. Ua kam diktuar njerëzve që janë mundu në Kosovë
25 që ta publikohet nga Kosova, jo unë të bëj deklarata nga

1 perëndimi për një arsye. Se botimet e komunikatave që do të
2 kishin dalë në Bruksel apo gjetiu, do të kish dalë në shesh se
3 këto gjëra nuk vijnë prej Kosovës, por i bën dikush nga
4 Brukseli, a nga Parisi, a Gjeneva. Përkthimin që e lexoi
5 Prokurori është i pasaktë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Mbrojtës, e keni fjalën.

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ne e sugjerojmë që të
9 lexohet më vonë ky [pasazh] kur thuhet se "Përsëris edhe një
10 herë këtë që e them". Sepse përmban atë kontradiktën me atë që
11 thotë dëshmitari. Duhet, domethënë, që të kemi një kontekst të
12 plotë, duhet të lexojmë edhe një apo dy paragrafët më lart.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A është paragrafi me "E
14 përsëris edhe një herë edhe atë që ka thënë Gani Geci"?
15 Dëshmitari këtu përmend që komunikata është diktuar nga selia
16 e NATO-s. Dhe është e saktë se konteksti do ta bënte këtë më
17 të qartë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
19 të vazhdoni, Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Atëherë, dëshmitar, a e keni diktuar këtë komunikatë
22 nëpërmjet telefonit apo jo?

23 PË. E kam diktuar komunikatën që ka qenë kërkesë e NATO-s dhe
24 e Shteteve të Bashkuara. Nuk e kam shkruar unë.

25 PY. Në rregull, faleminderit shumë. Mund të vazhdojmë.

1 Vetëm dhe një gjë. Kujt ja diktutë komunikatën?

2 PË. Ja kam diktuar Kadri Veselit, me sa kujtoj, në qoftë se
3 nuk kam bërë ndonjë gabim, sepse ka kaluar një çerek shekulli
4 nga ajo periudhë dhe ekziston mundësia edhe gjërat të
5 ngatërrohen.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e
7 dimë që kjo ka ndodhur para shumë, shumë, kohe, dhe se ju këtu
8 jepni dëshmi simbas asaj siç ju kujtohen më së miri ngjarjet.
9 Dhe këtë e kemi parasysh.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 PY. Z. Mahmuti, e diskutuam rolin tuaj brenda UÇK-së,
12 kontaktet me ndërkombëtarët. Dua me ju të diskutoj disa
13 deklarata që i keni bërë në lidhje me politikat e UÇK-së në
14 lidhje me piketimin e civilëve.

15 Z. Mahmuti a ju kujtohet t'i keni dhënë një intervistë
16 një magazini me emrin *Christian Science Monitor* më datën 15
17 prill 1998? E di që ka kalu shumë kohë, por a ju kujtohet të
18 keni dhënë një intervistë për këtë gazetë?

19 PË. Fillimisht ju sqaroj se unë anglisht nuk flas, dhe nuk
20 kam pasur mundësi t'u jap, asnjëherë nuk më kujtohet që i kam
21 dhënë intervistë një gazete amerikane. Nëse është fjala për
22 një gazetë amerikane, asnjëherë nuk i kam dhanë.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
24 vendosim në ekran dokumentin me numër 0034909 deri në numër
25 0034116 [sipas përkthimit]?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Vendosni këtë dokument në ekran znj. Sekretare.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është fonti shumë i imët i

4 shkronjave. Duhet ta zmadhojmë pak. Nuk kemi për fat të keq

5 përkthim në shqip, do ta lexoj dhe me përkthimin ndoshta do ta

6 ndihmojmë z. Mahmuti.

7 PY. Simbas faqes së parë të këtij dokument. Ju së bashku me

8 Jashar Salihun dhe Bilal Sherifin, keni diskutuar, keni folur,

9 keni dhënë një intervistë për këtë publikim.

10 Pyetja e parë e imja për ju është, a e njihni z. Salihu

11 dhe z. Sherifi?

12 PË. Me Jashar Salihun dhe Bilall Sherifin kemi mbajtur shumë

13 konferenca me gazetarët në selinë e Kombeve të Bashkuara në

14 Gjenevë. I njof personalisht të dytë, Jashar Salihu nuk është

15 në mesin e të gjallëve, është një njeri i cili ka statusin e

16 heroit të Kosovës.

17 PY. Data në këtë botim është 15 prill 1998, në paragrafin e

18 fundit të këtij dokument që e shikojmë këtu në ekran, tre

19 persona, domethënë ju, z. Jashari dhe Salihu, kanë folur për

20 herë të parë haptas në një intervistë me Monitorin në lidhje

21 me "strategjinë e UÇK-së, qëndrimet e UÇK-së dhe me

22 mbështetjen e komunitetit shqiptar nga e gjithë bota për UÇK-

23 në."

24 A ju rifreskon kjo memorien tuaj në lidhje me këtë

25 intervistë botuar këtu në vitin 1998?

1 PË. Data 15 prill më vë të dyshoj rreth vërtetësisë së kësaj,
2 sepse mund t'jua siguroj Gjykatës takimet që kam pasë në
3 Paris, në atë periudhë nuk e di saktësisht, do të jetë prej
4 10-shi deri nga 15-shi kam qenë në Paris, që mund të
5 verifikojë edhe në internet takimet ku kanë qenë intelektualë,
6 si Bernard Lévy, Herzog, e personalitete [E pakuptueshme] e të
7 tjerë që kanë qenë në këtë periudhë unë kam qenë, domethënë,
8 gjasat janë shumë reale se për t'u botuar më 15 prill, më 14
9 prill do të ishte dashë që unë të jepja intervistë. Te
10 besueshmëria nuk jam i sigurt, por nëse kam pesë minuta kohë
11 qasje në internet jua gjej saktësisht ku kam qenë në këtë
12 datë.

13 Sepse në këtë periudhë të mesit të prillit, kam qenë në
14 Paris në takime që kam pasë të shumta me intelektualë
15 francezë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 qoftë se e kuptova mirë, këto paragrafë që i citoi Prokurori,
18 nuk ua rifreskojnë kujtesën në lidhje me mundësinë nëse e keni
19 dhënë një intervistë të tillë ose jo. A ju kam kuptuar drejt
20 se çfarë doni të thoni?

21 Domethënë, ju nuk e keni dhënë këtë intervistë, këtë po e
22 thoni, dëshmitar?

23 PË. Data 15 prill më bën të dyshoj në vërtetësinë se unë kam
24 qenë pjesë e një interviste të tillë. Nuk jam i sigurt, mund
25 ta verifikoj dhe t'ju sjell prova se ku kam qenë në atë kohë.

1 Vetëm data 15 prill më bën të hezitoj.

2 Ende nuk e di përmbajtjen e intervistës, çka është thënë
3 brenda nuk e di meqenëse nuk është përkthimi. Por data më bën
4 të dyshoj se --

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
6 falni, por përmbajtja -- e këtij publikimi u nda me ju
7 pjesërisht. Unë do t'i jap Prokurorit fjalën që ta elaborojë
8 këtë pjesë. Por intervista jep informacion të mëtejshëm në
9 lidhje me atë në dukje, domethënë, se kur është kryer.

10 Vazhdoni, z. Prokuror.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetëm një minutë, ju lutem.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
13 përkthim]

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër, të
15 nderuar Gjykatës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
17 përkthim]

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 PY. Paragrafi i tretë, në këtë faqe thotë se:

20 "Intervista me tre ish-të burgosurit politikë u organizua
21 nga operativi kryesor i Shteteve të Bashkuara, një emigrant
22 nga Kosova i cili ka familje në UÇK dhe takohet rregullisht me
23 udhëheqësit e tyre në Evropë. U mbajt nga fundi i kësaj jave
24 në Aarau, një fshat që është 30 milje jashtë Cyrihut, në *Zërin*
25 e Kosovës, një gazetë e publikuar nga anëtarë të asaj partie

1 të cilëve u ishte miratuar azil politik në Zvicër në fillim të
2 viteve 1990.”

3 A ua rifreskoi kjo memorien z. Dëshmitar?

4 PË. Përmendja e zyrove të gazetës Zëri i Kosovës në Aarau
5 dëshmon se ajo çka është shkruar këtu sa më përket mua, nuk
6 është aspak e vërtetë. Asnjë intervistë, asnjë, nuk kam dhënë
7 me asnjë gazetar të huaj në zyrat e gazetës Zëri i Kosovës.
8 Kjo është më se e sigurt. Unë nuk kam qenë i pranishëm në
9 asnjë intervistë, jo me këta gazetarë, por me asnjë gazetar të
10 huaj në selinë e Zërit të Kosovës në Aarau.

11 PY. Por ju në atë kohë ishit në Zvicër, apo jo?

12 PË. Po, kam qenë në Zvicër. Aarau, selia e Zërit të Kosovës
13 është 250 kilometra larg vendit ku unë kam banuar. Dhe për një
14 intervistë 500 kilometra t’i bëj, nuk kam pranuar në ato --
15 unë kryesisht me gazetarët kam mbajtur konferenca të rregullta
16 në selinë e Kombeve të Bashkuara dhe kam dhënë shumë pak
17 intervista individuale.

18 PY. Do të vazhdoj. Sipas kësaj interviste, së pari t’ju pyes
19 kështu, a jeni duke e mohuar kategorikisht pjesëmarrjen tuaj
20 në këtë intervistë apo lejoni mundësinë që kjo mund të ketë
21 ndodhur? Me fjalë të tjera, a jeni duke thënë që “asnjëherë
22 s’e kam dhënë këtë intervistë” apo jeni duke thënë se “nuk më
23 kujtohet, mirëpo ekziston mundësia që mund edhe të ketë ndodhë
24 ta kem dhënë këtë intervistë”?

25 PË. Jam i sigurt, 100 për qind, që asnjë intervistë me

1 gazetarë të huaj nuk kam dhënë në selinë e gazetës Zëri i
2 Kosovës, në Aarau.

3 PY. Pra, ky artikull që ju bën bashkë me dy persona të tjerë
4 që ju i njihni në vendin ku keni jetuar në atë kohë, është
5 shpifje. Asgjë që shkruan aty pra nuk është e vërtetë, sa i
6 përket pjesëmarrjes tuaj në atë intervistë. Kjo është dëshmia
7 juaj sot.

8 PË. Pa e ditë përmbajtjen e tërësishme, garantoj se asgjë nuk
9 ka të vërtetë sa më përket mua. Nuk di çka përmban në tërësi,
10 por asnjë intervistë, jo me këta gazetarë, me asnjë gazetar të
11 huaj, nuk kam dhënë selinë e -- Bilal Sherifi është gjallë,
12 mund ta ftoni dhe ta pyetni atë. Janë anëtarë të redaksisë së
13 Zërit të Kosovës që janë gjallë, që mund të dëshmojnë, se
14 asnjëherë Bardhyl Mahmuti nuk ka dhënë intervistë në selinë e
15 gazetës Zëri i Kosovës me gazetarë të huaj.

16 PY. Kalojmë. Dua t'ju tregoj një fragment të kësaj
17 interviste, mbase ju ndihmon kjo për t'ju rifreskuar kërkesën,
18 dhe pastaj flasim për përmbajtjen.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Avokat.

21 Z. AOUINI: [Përkthim] E kundërshtoj. Ai po thotë qartë,
22 unë s'kam lidhje me këtë përmbajtje. Dëshmitari po thotë, as
23 me vendin, as me datën, as me redaksinë e kësaj gazete, nuk
24 kam qenë. Tani çfarë doni -- si mund t'i lexoni atij diçka që
25 ai e mohon?

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, dëshmitari tha "Nuk e njoh
2 tërësisht përmbajtjen", unë dua t'i jap më shumë përmbajtje
3 dhe pastaj ta pyes a pajtohet, a s'pajtohet, me këto që do
4 them.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Por dëshmitari po thotë - më falni
6 që po këmbëngul, ai thotë - ai po thotë nuk është nevoja të
7 shkojmë në përmbajtje. "Kam kritere të tjera që më bindin që
8 s'kam qenë në këtë intervistë". Pra, ai nuk po kërkon
9 përmbajtjen për të rifreskuar kujtesën. Ai po thotë, edhe pa
10 ditur përmbajtjen ju garantoj që nuk është e vërtetë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
12 Prokurori po përpiqet që përmes informacionit, përmes
13 përmbajtjes së kësaj interviste, të kuptojë -- mbase ka ndodhë
14 diku tjetër, mbase mund të ketë ndonjë gabim këtu, ku është
15 bërë intervista. Ai po përpiqet t'i rifreskojë sa më shumë
16 kujtesën dëshmitarit, të paktën unë kështu e kuptoj.

17 Vazhdoni, Prokuror.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
19 PY. Është kjo -- artikulli thotë.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në faqen tjetër, do të shkojmë
21 në faqen tjetër me ERN që mbaron me -111. Faleminderit.

22 PY. Artikull thotë kështu:

23 "UÇK-ja, ka vrarë vetëm anëtarë të strukturës shtetërore
24 represive", tha z. Mahmuti, duke përdorur akronimet në gjuhën
25 shqipe për UÇK-në. 'Një gjë duhet të jetë e qartë, strukturat

1 e shtetit represiv janë të krijuara nga zyrtarë të veshur me
2 uniforma dhe pa uniforma'".

3 Pyetja ime e parë është: A ju kujtohet një deklaratë e
4 tillë t'ia keni dhënë një deklaratë të tillë gazetarëve të
5 kësaj revistës, *Christian Science Monitor*? Po, ose jo? A ju
6 kujtohet një deklaratë e tillë?

7 PË. Një deklaratë identike e kanë publikuar mediat pas
8 takimit që kam pasur me Gelbard në Gjenevë. Gelbard më ka
9 pyetur si shpjegohet që në raste të caktuara ka njerëz civilë
10 të vrarë? Kam thënë tekstualisht, "Cak i sulmeve të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës janë pjesëtarët e aparateve represive".
12 Aparatet represive si gjithkund në botë bëhen nga njerëz me
13 uniformë dhe pa uniformë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës as nuk
14 ka pasë cak vrasje të civilëve, por shkatërrimin e pjesëtarëve
15 të aparateve represive.

16 Kjo ka qenë deklaratë publike dhe kanë mundë të marrin
17 këta gazetarë, gazetarët që e kanë marrë nëpër mediat e tjera
18 dhe kanë mundë të sqarojnë një gjë të tillë. Nuk i kam dhënë
19 këtë deklaratë asnjë gazetari sepse është një deklaratë
20 publike pas takimit që e kam pasë me Gelbard në Gjenevë.

21 Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara, z. Gelbard. Ka mundë ta
22 lexojnë edhe këta gazetarë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Dëshmitar, faleminderit për përgjigjen tuaj, se tani u sqarua.

25 Por kam unë një pyetje. Po ju, keni qenë në dijeni që ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 96

1 ekzistuar ky artikull? E dinit që ka ekzistuar ky artikull?

2 DËSHMITARI: Jo. Meqenëse nuk lexoj në gjuhën angleze, nuk
3 kam mundë të jem në dijeni të një gjeje të tillë. Por e di që
4 shumë media e kanë publikuar pikërisht këtë deklaratë sepse
5 kjo deklaratë ka qenë një ndër çështjet ma konfliktoze
6 ndërmjet Robert Gelbard dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
7 sepse ai në takimin që kemi pasë tha "Unë nuk e kam cilësuar
8 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si organizatë terroriste, por
9 kam thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë dhe aksione
10 terroriste". Prandaj, ka kërkuar nga unë të sqaroj si e
11 shpjegoj rastin se janë vrarë edhe njerëz. Në qoftë se më
12 lejoni vetëm një sekondë, znj. Gjyqtare. Më lini --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
14 një pyetje, kam një pyetje. Kur është bërë ky takim që i ke
15 thënë këto? Ju kujtohet kur është mbajtur ky takimi?

16 DËSHMITARI: Po. Në qershor të vitit 1998.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me
18 kaq po e lejoj për momentin, dhe po ia rikthej fjalën
19 Prokurorit.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]:

21 PY. Por artikulli është 5 prill i 1998 [sipas përkthimit],
22 këtë datë ka artikulli. 5 prill i 1998 [sipas përkthimit]. Ju
23 thoni që deklaratat i keni bërë në një takim në muajin qershor
24 të 1998. A thatë këtë? Po ju pyes, vetëm ta sqarojmë këtë
25 pjesë se nuk po e kuptoj.

1 PË. Unë sqaroj çka kam thënë dhe çka ka qenë në media.
2 Çështjen -- të njëjtat deklarata i kam ba vazhdimisht në të
3 gjitha konferencat me gazetarët. Ia kam përsërit Gelbard, ia
4 kam përsëritë në Bruksel, në gjitha qendrat, në Paris, të
5 njëjtin qëndrim e kam përsëritë.

6 PY. Në rregull, shumë mirë. Pra në qershor 1998, thoni që
7 "kam bërë këtë deklarata". Pranoni që keni bërë në qershor
8 1998, kështu?

9 PË. Nga muaji mars 1998 deri në qershor të vitit 1999, kam
10 mbajtur përmbi 30 konferenca me gazetarët në selinë e Kombeve
11 të Bashkuara në Gjenevë. Gjithmonë e kam përsëritë të njëjtën
12 gjë. Nuk më kujtohet saktësisht ku e kam përsëritë, por
13 gjithmonë e kam përsëritë këtë qëndrim. UÇK-ja nuk ka vra
14 civilë, edhe është e qartë.

15 PY. Ju kujtohet ta keni dhënë këtë deklaratë në qershor 1998?
16 Pra, ju kujtohet, këtë po thoni tani? Po ju kujtohet që në një
17 moment në qershor 1998 e keni thënë këtë deklaratë, kështu?

18 PË. E kam thënë edhe para qershorit, e kam thanë edhe me një
19 libër që është botu në Francë i titulluar "*La naissance de la*
20 *lutte armée*", e kam përsëritë vazhdimisht prej marsit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Kërkoj ndjesë se fola pa mikrofon. Tani e morëm përgjigjen.

23 Vazhdoni ju lutem.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 PY. A mund të na shpjegoni, kush ishin këta personat pa

1 uniforma që shënjestronte UÇK-ja? A mund të ishin dhe civilë
2 këta, shqiptarë të Kosovës, civilë? A mund të ishin pra këta
3 edhe civilë shqiptarë të Kosovës, këta personat pa uniformë?
4 PË. Jo. Në librin "Mashtrimi i madh" janë të ilustruar me
5 fotografi dy pjesëtarë pa uniforma që janë pjesëtarë të
6 policisë serbe për të cilat Serbia ka ba propagandë se kanë
7 qenë civilë, por më vonë është shtrëngu të thotë që kanë qenë
8 pjesëtarë --

9 PY. Shumë mirë, në rregull. Z. Mahmuti, a po thoni ju që
10 asokohe UÇK-ja nuk shënjestronte asnjë civil shqiptar të
11 Kosovës, kështu?

12 PË. Plotësisht e saktë. Në orientimin --

13 PY. Kaq, mjafton.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përfundova
15 me këtë dokument.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Mendoj që edhe dëshmitari ka qenë i qartë në fakt lidhur me
18 këtë pikë. Kështu që nuk do doja të thelloheshim më shumë në
19 këtë temë me përjashtim të rastit në qoftë se kemi diçka shumë
20 konkrete.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Por kam një dokument tjetër që
22 dua ta diskutojmë me dëshmitarin, SPOE00209429 deri në -- jo.
23 Kaq, kaq është, një faqe vetëm. SPOE00209429-00209429 shqipja,
24 ndërsa anglishtja mbaron me -ET në fund dhe Revised.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

1 mund të na shpjegoni qëllimin?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

3 Qëllimi është t'i tregoj një komunikatë të Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës ku përmendet vrasja e një personi që ne
5 e dimë që është civil. Kjo lidhet drejtpërdrejt me
6 besueshmërinë ose mbështetshmërinë e asaj që sapo tha
7 dëshmitari.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull, vazhdoni.

10 Shoh që në të majtën time Avokati u çua në këmbë.

11 Avokat, doni të thoni diçka?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Po më thonë që ky është një nga
13 dokumentet që nuk u lejua.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, është një nga dokument që u
15 rishqyrtua nga Trupi Gjykses.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit që jeni kaq i vëmendshëm ndaj këtyre.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Atëherë a mund të na bëni një
19 shpjegim? Ne dëgjuam me vëmendje. Ne prapë nuk po e kuptojmë
20 dhe e vlerësojmë çdo shpjegim si do ta përdorë -- Prokuroria
21 këto pyetje-përgjigje për të vërtetuar besueshmërinë? Çfarë
22 lidhje ka kjo? Si do ta vlerësojnë ata besueshmërinë e
23 dëshmitarit në bazë të këtyre dokumenteve?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por e
25 shohim ne lidhjen dhe do ta lejojmë. E kemi diskutuar disa

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 100

1 herë këtë temë. Po, e kuptoj që ju s'po e kuptoni dot lidhjen,
2 por ne duhet ta vlerësojmë, duhet ta shohim ku do shkojë. Kjo
3 është e sigurt.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. E shihni këtë? Zëri i Kosovës, gazeta që diskutuam, edhe
6 këtu janë dy deklarata politike. 42 dhe 43.

7 PË. Nuk jam duke e pa -- nuk jam duke e pa, nuk lexohet në
8 gjuhën shqipe. Nëse mund të zmadhohen.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
10 keni më të qartë tani?

11 DËSHMITARI: Shihet më qartë, po.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

13 PY. Kjo komunikatë, në fillim të faqes, shohim që është
14 botuar më 5 mars 1998. Që është të paktën 5 ditë [sipas
15 përkthimit] përpara artikullit që ju përfshinte dhe ju. Dhe
16 shumë kohë përpara asaj konferencës kur keni bërë deklaratën
17 tuaj në qershor, si periudhë kohore.

18 Tani, komunikata -- e lexoni z. Mahmuti? Mund ta lexoni
19 apo ta zmadhojmë pak më shumë?

20 PË. Po, më mjafton.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 43
22 apo...?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] 42, duhet të shohim 42. Ju
24 kërkoi ndjesë.

25 Dëshmitar, mund ta lexoni komunikatën numër 42? Është e

1 qartë?

2 DËSHMITARI: Po.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Thotë:

5 "Me vendim të Shtabit Qendror të UÇK-së, gjatë janarit
6 dhe shkurtit njësitë tona të armatosura kryen një varg sulmesh
7 kundër forcave të policisë serbe dhe bashkëpunëtorëve të
8 tyre."

9 Tani këtu ka një dallim mes policisë nga njëra anë dhe
10 bashkëpunëtorëve nga ana tjetër. Bëhet dallim mes këtyre të
11 dyjave. Kjo kategoria e dytë për cilën njerëz bëhet fjalë?
12 Kush janë këta njerëzit e kësaj kategorie të dytë?

13 PË. Në kategorinë e bashkëpunëtorëve janë pjesëtarë të
14 aparateve represive, konkretisht këtu flitet për policinë, ata
15 që kanë hy së bashku me strukturat policore që janë vu në
16 shërbim të okupatorit të Kosovës. Bashkëpunëtorët në këtë rast
17 janë pikërisht ata njerëz që kanë hy në shërbim të okupatorëve
18 të popullit tonë.

19 PY. Pra, nuk janë e njëjta gjë si policia, kështu? Nuk janë
20 forca policie, janë kategori tjetër, janë dy kategori të
21 ndara.

22 PË. Janë pjesë e kësaj strukture që bante represion, janë
23 pjesë të aparateve represive.

24 PY. Nëse lexojmë pak më poshtë, thuhet:

25 "Më 13 shkurt 1998, u likuidua Mustafë Kurti,

1 bashkëpunëtori i pushtuesit.”

2 Z. Dëshmitar, z. Mahmuti, e njihni kush ishte Mustafë
3 Kurti?

4 PË. Jo, nuk e njof personalisht, por asaj çka ka qenë e
5 shkruar i kam besuar.

6 PY. Po sikur t'ju them unë që ai ishte një nëpunës i zyrës
7 postare në Drenoc në kohën që u vra, a nuk e konsideronit
8 civil ju këtë person?

9 PË. Nëse unë e përmbys pyetjen dhe pyes çfarë garancie keni
10 që nuk ka qenë pjesë e strukturave të aparateve represive ky
11 njeri?

12 PY. Dikush --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
14 t'ju kujtoj që duhet të ngadalësoni kur flisni dhe duhet të
15 prisni pak mes pyetjeve dhe përgjigjeve, pak sekonda. Kjo --
16 këtë e kam edhe për Prokurorinë edhe për dëshmitarin. Sepse
17 përndryshe flasin njëkohësisht personat dhe kjo e bën shumë të
18 vështirë punën e stenografes dhe të përkthyesve. E kuptojmë që
19 debati të bën t'i harron gjëra të tilla, por ju lutem kini
20 parasysh.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

22 PY. Ju keni qenë anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së. Jeni
23 marrë me politikat. Madje dhe një herë e keni diktuar --

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj dua të them diçka.

25 Nuk -- ku ka prova që ky person ka qenë nëpunës i zyrës

1 postare? Ka ndonjë provë?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë e pyeta dëshmitarin. Nëse
3 na kërkon Trupi Gjykses mund të paraqesim dhe prova për këtë.
4 Ka prova. Në seanca të tjera që janë mbajtur edhe nga të
5 afërmit e këtij personi që mund të na thonë çfarë pune ka
6 pasur ky person asokohe. Ne po ia themi dëshmitarit këtë gjë,
7 nëse doni prova shtesë për ta mbështetur këtë që thamë, me
8 kënaqësi mund ta bëjmë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 mjafton kjo?

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, dua një dokument që ta shoh.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 për momentin nuk është e mundur. Por e kuptoj ku doni të
14 dilni. Ndonëse nuk është çështja jonë, por e kuptoj, e kuptoj
15 çfarë doni të thoni. Kështu që mund të bëni parashtrime në
16 lidhje me këtë. Do të dal me një urdhër.

17 Shoh që dhe kolegu juaj u çua në këmbë, por tani u ul.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Dua ta shtoj, ai po thotë kjo është
19 përmendur në një çështje tjetër gjyqësore dhe përfshihet në
20 një tjetër çështje gjyqësore pastaj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
22 mos e fillojmë dhe një herë këtë.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pothuajse mbarova dhe me këtë
24 temën, do kaloj tek tema e fundit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 vazhdoni.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

3 PY. Ju keni qenë i përfshirë në shpërndarjen e politikave të
4 UÇK-së, madje na thatë më herët që një herë keni diktuar një
5 komunikatë dhe doli një komunikatë ku thuhej që është vrarë
6 një individ. Pra kjo komunikatë doli nga organizata juaj. Nuk
7 -- menduat ju se do të ishte normale që të kërkonit
8 informacion kush është ky person që u vra nga organizata ku
9 ishit ju? Pra, ju nuk u përpoqët të merrnit asnjë informacion
10 shtesë për të kuptuar çfarë personash shënjestronte
11 organizata?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
13 do ta lejojmë këtë pyetje.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull, po e kaloj.

15 PY. Pra, në dëshminë tuaj po na thoni që nuk e njihnit
16 identitetin e këtij personi, pra të Mustafë Kurtit, në kohën
17 kur u lëshua kjo komunikatë?

18 PË. Nuk e njihja.

19 PY. Z. Mahmuti, sot thatë, edhe kjo është reflektuar në faqen
20 56 dhe 57 të transkriptit provizor, të përkohshëm.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na
22 nevojitet më dokumenti në ekran?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk nevojitet më.

24 PY. Pra, ju në këtë pjesë të transkriptit keni thënë që nuk
25 keni pasur asnjë njohuri për ndalimin e civilëve prej UÇK-së.

1 Ju thatë që nuk dini asnjë rast të tillë, kështu?

2 PË. Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
4 keni bërë një herë këtë pyetje. Disa herë madje. Apo doni të
5 filloni diçka tjetër dhe doni ta jepni si kontekst?

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, është pak si kontekst.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
8 atëherë bëjeni të qartë sepse i është përgjigjur.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë doja ta pyesja.

10 PY. A ka dijeni dëshmitari lidhur me gjykimin që është
11 mbajtur kundër Latif Gashit, Rustem Mustafës dhe të akuzuarve
12 të tjerë për krime të kryera në zonën e Llapit prej Ushtrisë
13 Çlirimtare të Kosovës? Është një aktgjykim publik ky. Keni
14 dijeni për këtë?

15 PË. Nuk e kam lexuar aktgjykimin, nuk e kam përcjellur
16 procesin sepse kam pasur bindjen e plotë pa marrë parasysh
17 kush ka qenë në ato struktura gjyqësore, proceset janë sajuar
18 me dëshmitar të rrejshëm.

19 PY. Pra, po thoni që dënimi i z. Gashi dhe z. Mustafa është
20 bazuar në dëshmitarë të rrejshëm, këtë po thoni në dëshminë
21 tuaj?

22 PË. Unë mund t'i sjell Gjykatës, nëse më lejon, shembuj të
23 panumërt ku shqiptarët janë dënuar mbi bazën e dëshmitarëve të
24 rrejshëm të cilët kanë dëshmuar kundër personave të pafajshëm,
25 madje edhe raste -- ju lutem ta -- madje edhe raste ku vetë

1 kanë nënshkruar për gjoja pjesëmarrje në krime e më vonë ka
2 dalë e vërteta se ata nuk kanë qenë të përfshirë në krime, por
3 kanë qenë të detyruar ta nënshkruajnë gjëra të atilla.
4 Prandaj, në këtë kontekst ku dëshmitë ofrohen nga autoritetet
5 serbe për gjykatat që u krijuan në Kosovë në patronazhin e
6 UNMIK-ut, për mu kanë qenë tepër të dyshimta.

7 Vetëm një shembull, znj. Gjyqtare. Zyrtarisht që mund të
8 dëshmohet me prova, 27.000 faqe --
9 PY. Mjafton kaq. Dua t'ju pyes tani, po aktgjykimin kundër
10 Sabit Gecit dhe të tjerëve që e ka lëshuar Gjykata Themelore e
11 Mitrovicës, a e njihni?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
13 t'i jap fjalën Avokatit.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk kemi asnjë lloj lidhje me këto
15 çështje gjyqësore. Nuk na është lejuar, as një palë nuk duhet
16 lejuar, në qoftë se nuk na lejuan ne nuk kanë pse të lejojnë
17 palën tjetër. Ka një kufi për fabrikimin e provave. Ne nuk na
18 lejuan që të përmendim çështje të tjera në lidhje me
19 fabrikimin e provave, që nuk lidhen drejtpërdrejt me çështjen
20 Shala. Pse po e bëjmë këtë gjë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
22 po jep -- është në kontekst tjetër, Avokat.

23 Sidoqoftë po i drejtohem Prokurorit. Unë nuk e dëgjova
24 pyetjen tuaj.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pyetja ime është kështu. A ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 107

1 dëshmitari, a po thotë dëshmitari që dhe aktgjykimi në
2 çështjen kundër Sabit Gecit dhe të tjerëve, lidhur me krimet
3 që kanë ndodhur në Kukës në Shqipërinë e veriut, a po thotë
4 dëshmitari që dhe ky aktgjykim është mbështetur nga fabrikime
5 nga serbët dhe është një aktgjykim i bazuar në fabrikime? A
6 është kjo dëshmia juaj?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
8 prit, prit. Para se të përgjigjet dëshmitari. Prisni një çast.

9 Vazhdoni, por dua të bëj një koment për Avokatin. A mund
10 ta sqaroni pse nuk paska kjo lidhje me çështjen gjyqësore? Pse
11 thoni që nuk është relevante, nuk ka lidhje?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Po ne nuk na lejuan që të përmendim
13 disa çështje gjyqësore lidhur me fabrikimin e provave, dhe kjo
14 ishte ku e bazova unë kundërshtimin tim. Tani, kolegu im i
15 nderuar po flet për një çështje gjyqësore dhe thotë që kjo
16 çështje gjyqësore ka lidhje dhe qenka ndryshe. Dhe kjo është
17 gjëja e vetme mbase që mund të themi është deri diku
18 relevante.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
20 është konstatimi juaj. Trupi Gjykes -- Trupi Gjykes i ka
21 pranuar pyetjet, disa pyetje, por komenti juaj ishte ky. Ju
22 thatë: E kundërshtojmë pyetjen e Prokurorit, dhe me sa duket
23 ju e dëgjuat pyetjen e Prokurorit, unë nuk e dëgjova mirë. Ai
24 e përsëriti pyetjen tani dhe unë po ju përgjigjem tani. Që kjo
25 pyetje specifike, dhe unë mendova se për këtë e patët edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 108

1 kundërshtimin, unë po them që pyetja e tij lidhet me çështjen
2 tonë gjyqësore. Po ju dëgjoj, nëse keni për të bërë një
3 konstatim dhe nuk pajtoheni me diçka, unë dua që ta trajtojmë.

4 Dhe në këtë rast po ju them që në këtë rast ka lidhje dhe
5 ju e pranoni.

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Po çështja Geci për Kukësin është,
7 kështu që ka relevancë.

8 Unë ju kërkoj ndjesë, po ky është konstatimi im dhe ky
9 vlen dhe për ato që janë thënë më përpara.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit për sqarimin.

12 Vazhdoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 PY. Po e bëj këtë pyetje sepse ka disa aktgjykime publike
15 edhe kanë kaluar dhe apelin, janë rigjykuar, edhe janë të
16 njohura mbarëbotërisht në Kosovë. Dhe një person si ju që ka
17 shkruar libra është krejt normale të hamendësohet që t'i keni
18 lexuar aktgjykime të tilla për t'u informuar dhe për të dalë
19 në përfundime të caktuara. Prandaj, po ju pyes, a e keni
20 lexuar ju aktgjykimin në çështjen kundër Sabit Gecit dhe të
21 tjerëve?

22 PË. Znj. Gjyqtare, kam nevojë dy minuta sqarim. Nga momenti
23 kur kam --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
25 t'i përgjigjeni pyetjes?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 109

1 DËSHMITARI: Lidhet me përgjigjen, po. Po. Aty jam.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Përgjigjuni pyetjes, ju lutem.

4 DËSHMITARI: Nga momenti kur kam --

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

6 PY. Vetëm kaq, a e keni lexuar aktgjykimin, z. Mahmuti,

7 pastaj na shpjegoni. Por si fillim, a i keni lexuar

8 përfundimet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Është

9 aktgjykim i vitit 2011, është një aktgjykim publik i 29

10 korrikut 2011. A e keni lexuar ndonjëherë këtë?

11 PË. Asnjë aktgjykim, asnjë proces gjyqësor që është ba mbi

12 bazën e 27.000 faqeve dokumentacion, që shërbimi sekret i

13 Serbisë u ka dorëzuar autoriteteve të UNMIK-ut në Kosovë, nuk

14 i kam lexuar. Zyrtarisht, shefi i shërbimit sekret serb --

15 PY. Vetëm kaq z. Mahmuti, një pyetje me "po" ose me "jo", a e

16 keni lexuar, "po" ose "jo"?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

18 duhet të flisni njëkohësisht, e theksoj edhe një herë. Prisni

19 të mbarojë dëshmitari pastaj bëni pyetjen.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Atëherë, pyetja është, e keni lexuar apo jo aktgjykimin?

22 Ne s'po e kuptojmë. A e keni hapur atë, a e keni shfletuar atë

23 aktgjykim dhe a e keni lexuar përmbajtjen e tij?

24 PË. Nuk mundeni ta kuptoni nëse nuk më lëni ta shpjegoj.

25 Duhet ta shpjegoj. Se unë i bindur që --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 110

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 pyetja është, a e keni lexuar aktgjykimin?

3 DËSHMITARI: Asnjë aktgjykim të sajuar mbi provat e
4 Serbisë nuk e kam lexuar dhe asnjë proces gjyqësor nuk kam
5 ndjekur, sepse kanë qenë mbi prova dhe mbi dëshmitarë të
6 përgatitur nga Serbia. Nuk lexoj procese gjyqësore të sajuara.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Prokuror, për hir të së vërtetës, në faqen 102, rreshtat 1
10 deri në 3, ai u përgjigj një herë dhe tha:

11 "Asnjë aktgjykim apo çështje penale të bazuar në prova të
12 rrejshme", diçka të ngjashme "nuk e kam lexuar".

13 Pra, desha të them është përgjigjur dy herë kësaj
14 pyetjeje dhe përgjigjen e ka pasur të qartë.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 PY. Në fillim na treguat për metodologjinë e hulumtimeve
17 tuaja. A mendoni që keni pasur një metodologji të shëndoshë
18 për të formuar dhe për t'u publikuar opinionin për diçka që ju
19 s'keni lexuar?

20 PË. Po, sepse kam lexuar deklaratën e shefit të shërbimit
21 sekret serb, i cili thotë, "Nëse nuk më lironi nga burgu",
22 është i dënuar 40 vjet burg për krimet që ka bërë në Serbi,
23 "nëse ju nuk më lironi, do ta publikoj listën e civilëve të
24 vrarë serbë, shqiptarë, dhe të përkatësive të tjera etnike që
25 i ka vrarë shërbimi sekret dhe që ua është veshë Ushtrisë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 111

1 Çlirimtare të Kosovës". Ai thotë nëse e publikon listën
2 zyrtarisht, shefi i shërbimit sekret, do të gjunjëzohet shteti
3 serb. Krime të tmerrshme janë bë. Mua nuk më ka interesuar
4 doraci a e ka emrin Nazim Bllaca --

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull, në rregull.

7 DËSHMITARI: -- nëse më lejoni vetëm edhe një minutë.

8 E ka emrin Nazim Bllaca doraci, a e ka Slavko Nikiç, që e
9 keni fotografinë e veshur, kolonel i policisë serbe --

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
11 jo, jo, jo. Këtu duhet ta ndërprejmë. Ju jeni i qartë. E keni
12 bërë të qartë qëndrimin tuaj në lidhje me këtë temë. Mjafton
13 kaq.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mendoj që kam mbaru me këtë
15 temë. Kam vetëm dhe pjesën e fundit që më ka mbetur, më duhen
16 ndoshta edhe nja 15, 20 minuta.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
18 Fjalën e keni ju, Mbrojtja.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Për referencë të saktë, në faqen
20 2539 të transkriptit.

21 PY. Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes dje, faqja e transkriptit
22 2539, rreshtat 21 deri 25, ne me dëshmitarin diskutuam
23 metodologjinë. Dëshmitari e tha qartë se metodologjia e tij
24 ishte që të mbështetet në vetë burimet serbe. Dhe tani t'i
25 thuhet atij se pse s'i ka lexuar aktgjykimet që janë nxjerrë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 112

1 në Kosovë, në terma të përgjithshme nuk është kundërshtim i
2 metodologjisë. Ai ka përdorur një metodologji të caktuar dhe
3 këto kanë qenë burimet serbe. Domethënë, 95 për qind të
4 paktën, janë bazu në bazë të burimeve të vetë Serbisë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku
6 doni të dilni me këtë?

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Sa i përket metodologjisë, këtë
8 doja të them.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Juve
10 do t'ju lejohet që t'i bëni këto parashtime atëherë kur të
11 duhet. Mirëpo tani, ku doni të dilni me këtë? Sepse këtu jemi
12 në sallë të gjyqit, kemi një dëshmitar këtu. Çfarë doni të
13 thoni me këtë -- vërejtje?

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Desha që në transkript të jetë
15 qartë që kemi kundërshtuar pyetjen që u është bërë në lidhje
16 me metodologjisë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
18 është tani momenti për të bërë kësi lloj vërejtjesh. Është e
19 drejtë legjitime që të bëhen vërejtje, është në rregull në
20 qoftë se doni të kërkonit të mos parashtrohet pyetja. Mirëpo në
21 qoftë se doni të bëni koment në lidhje me përgjigjet dhe
22 pyetjet mendoj se kjo nuk është me vend.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kërkoj leje, e nderuar Gjykatëse.
24 Duhet të jemi të drejtë me dëshmitarin. Ne po flasim për
25 metodologjinë këtu, dhe nga ana tjetër po flasim për diçka

1 krejt tjetër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat, është e ligjshme, lejohet të parashtrohet pyetja se
4 çfarë rezultati do të ketë kjo përgjigje për sa i përket
5 metodologjisë që ka përdorur dëshmitari se çfarë peshe do t'i
6 jepet, apo çfarë ndikimi do të jetë, kjo është diçka
7 krejtësisht tjetër.

8 Sidoqoftë, pyetja që bën Prokurori lejohet dhe kolegu
9 juaj, Avokati tjetër i Mbrojtjes filloi të jepte komente për
10 diçka që për mendimin tim nuk është e përshtatshme të
11 parashtrohet në këtë moment. Mendoj që është më mirë të na
12 lejoni të vazhdojmë me këtë dëshmitar sepse e shikoj që --

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, pajtohem me ju sa i përket
14 pyetjes. Mirëpo për sa i përket referencës për metodologjinë,
15 mendoj që kjo nuk është në rregull.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
17 kemi të qartë qëndrimin tuaj, e keni bërë të qartë.

18 Për këtë Trupi Gjykes mjafton që të dëgjojë një herë një
19 argument, nuk ka nevojë që argumenti të përsëritet.

20 Vazhdoni z. Prokuror.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A do të bëjmë pushim tani apo
22 do të vazhdojmë?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Mendoj që është koha e mirë që të bëhet një pushim, për gjithë
25 ne. 15 minuta, një pushim të shkurtër. Faleminderit që e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 114

1 përmendët këtë.

2 Z. Dëshmitar, do të bëjmë një pushim prej 15 minutash dhe
3 pastaj do të vazhdojmë deri në orën 16.00. Ju lutem, të na
4 duroni dhe pak, dhe ju falënderoj edhe një herë për angazhimin
5 tuaj sot.

6 DËSHMITARI: Faleminderit shumë. Jam i gatshëm t'ju duroj
7 aq sa të keni nevojë nëse mund të kontribuoj në ndriçimin e
8 gjërave.

9 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 15
11 minuta pushim. Seanca këtu ndërpritet.

12 --- Pauza fillon në orën 14.35

13 --- Seanca rifillon në orën 14.53

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
15 se erdhët përsëri. Shoh që nuk ka ndryshime në përbërjen e
16 Prokurorisë, e as në atë të Mbrojtjes.

17 Z. Shala na ndjek kështu që mund të vazhdojmë.

18 Të flasim pak për planifikimin përpara se ta thërrasim
19 dëshmitarin. E di që ZPS-ja na tregoi që do t'i duhet rreth 20
20 minuta apo gjysëm ore.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua të them që ndoshta edhe më
22 pak se aq.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju,
24 Mbrojtësi i Viktimave sa kohë do t'ju duhet?

25 Z. LAWS: [Përkthim] Kjo do të varet nga dëshmitari dhe

1 nga ndërprerjet, por realisht dikun midis 20 dhe 40 minuta.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
3 rregull.

4 Dhe tani Mbrojtjes i drejtohem, a do të ketë pyetje
5 shtesë Mbrojtja.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj që nuk do të kemi pyetje
7 shtesë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Atëherë, ju faleminderit për këtë informacion, i nderuar
10 Avokat i Mbrojtjes.

11 Të martën e ardhshme mbasdite, në qoftë se do të ketë
12 nevojë të vazhdojmë, a është në dispozicion Mbrojtja, e lirë,
13 atë ditë?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj që për fat të keq nuk jam
15 i lirë atë ditë. Kam një takim dhe atë e kam caktuar para
16 shumë kohësh. Është e vështirë që ta ndryshoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Atëherë, dikush prej ekipit tuaj për shembull, nga
19 bashkëmborjtësit a mund të jetë i pranishëm në Gjykatë atë
20 ditë?

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do ta diskutoj këtë me ekipin
22 tim.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
24 përpiqem që të shoh se kur mund të vijë ky dëshmitar përsëri,
25 në qoftë se është e nevojshme dhe të shohim se kur është e

1 lirë salla e gjyqit. Gjithashtu, duhet ta pyesim edhe
2 dëshmitarin në qoftë se do të jetë i lirë në ato ditë.

3 E pyetëm Mbrojtësin e Viktimave. Atëherë, për hir të
4 procesverbalit a do të jeni i disponueshëm të martën?

5 Z. LAWS: [Përkthim] Po, të martën po. Për sa i përket dy
6 mundësive të tjera që na i thatë, për të mërkurën dhe të
7 premtën, ne presim që Çështja 6 të zgjasë gjithë ditën.
8 Ndoshta do të jemi të disponueshëm të mërkurën, por jo të
9 premtën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Atëherë s'ju kam kuptuar drejtë herën e parë. Ndoshta atëherë,
12 mbasditja e ditës së mërkurë është ende opsion. Por, nuk do të
13 futemi në këtë për momentin. Për momentin po e lëmë të martën
14 mbasdite.

15 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po a duhet një herë ta pyesim
16 dëshmitarin, apo duhet të them unë informacionin që kemi nga
17 dëshmitari?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

19 Z. AOUBINI: [Përkthim] Dëshmitari ka biletën për t'u
20 kthyer në fund të kësaj jave. Në qoftë se lihet për javën
21 tjetër atëherë dëshmia duhet të bëhet me videolink.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
23 arsye se kthehet në shtëpi.

24 Z. AOUBINI: [Përkthim] Pikërisht për këtë arsye. Mund ta
25 pyesim edhe Zyrën për Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve

1 se kur e ka fluturimin të shtunën apo të premten.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
3 të ndryshohen datat e biletave. Ajo që ka rëndësi është në
4 qoftë se dëshmitari do të jetë i disponueshëm për të martën,
5 në qoftë se lind nevoja.

6 Ju Prokuroria jeni të lirë

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Jemi të lirë gjithë javën e
8 ardhshme, e nderuar Gjykatës.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
10 një herë për të kontrolluar ndoshta se e kam kuptuar drejtë.

11 A është e mërkura mbasdite një mundësi tjetër? Po për
12 Mbrojtjen është një mundësi mbasditja e ditës së mërkurë? Pra,
13 jo të martën, por të mërkurën.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua që ta kontrolloj njëherë nëse
15 jam i lirë ose jo dhe do t'ju jap një përgjigje deri në fund
16 të kësaj seancës sot.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Atëherë do të vazhdojmë me pjesën e fundit të pyetjeve të
20 Prokurorit.

21 Znj. Sekretare, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

22 Dhe duhet të gjithë të përpiqemi që të flasim më ngadalë
23 dhe të presim njëri-tjetrin. Kjo vlen edhe për ne Gjykatësit.
24 Me fjalë të tjera vlen për mua.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se u kthyet. Do të vazhdojmë me pjesën e fundit të
3 kundëpyetjeve nga ana e Prokurorisë.

4 Z. Prokuror, fjala është për ju

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Z. Dëshmitar, a keni llogari në Facebook? Keni profil në
7 Facebook?

8 PË. Po.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, një nga
10 dokumentet që ju vendosët të mos e përdorja është pikërisht
11 profili i dëshmitarit. Unë e kam dhe është materiali me
12 SPOE00341041. E kisha në listën time. Thjesht për ta pyetur a
13 është ky profili juaj i Facebook-ut. Në qoftë se më lejohet do
14 të doja të veproja në këtë mënyrë. Përndryshe do të tregoj një
15 postim që ka bërë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
17 është e nevojshme t'i tregojmë profilin e Facebook-ut. Ne
18 fillimisht nuk e kemi pasur të qartë çfarë materiali ka qenë.
19 Megjithatë, ne e dëgjuam dëshmitarin që tha "Po, ka një profil
20 në Facebook". Mund ta [e pakuptueshme] në qoftë se s'ka ndonjë
21 kundërshtim nga Mbrojtja mund ta shfaqim dhe në ekran. Shoh që
22 Mbrojtja po pohon me kokë.

23 Mirë, sa për procesverbal mund ta themi që po shohim
24 profilin në Facebook të z. Mahmutaj. Mahmuti.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është materiali me ERN

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 119

1 SPOE00341041-00341042.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 mund të vazhdoni.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe faqja e parë në këtë varg
5 numrash.

6 PY. Z. Mahmuti, a është ky profili juaj në Facebook?

7 PË. Po.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani. A
10 mund të vendosim në ekran një postim që kemi marrë nga profili
11 në Facebook i dëshmitarit, që ka datën 11 nëntor 2020. Që
12 është disa ditë pas arrestimit -- të arrestimeve që ka kryer
13 ZPS-ja. Me -- numri ERN është SPOE00341067-00341067. Dhe
14 anglishtja me të njëjtin numër, por përfundon me ET në fund.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Vazhdoni

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund ta zmadhoni pak
18 origjinalin që ta lexojë vetë dëshmitari.

19 PY. Dëshmitar, ky është një postim i juaj, një deklaratë e
20 juaja që e keni postuar më 11 nëntor 2020. Dhe thotë:

21 "Dhomat e Specializuar dhe Zyra e Prokurorit të
22 Specializuar të Kosovës nuk kanë asgjë të përbashkët me
23 institucionet e drejtësisë. Ato janë, me germa të mëdha,
24 NDËRMARRJE POLITIKE KRIMINALE që ka për qëllim të dëmtojë
25 luftën çlirimtare të popullit të Kosovës."

1 A është kjo një deklaratë që keni postuar ju personalisht
2 në profilin tuaj në Facebook?

3 PË. Është një deklaratë e shkëputur nga një kontekst më i
4 gjerë që duhet të sqarohet si kontekst se përndryshe si
5 deklaratë e shkëputur mund të konsiderohet si deklaratë
6 vetëfajësie. Prandaj, kam nevojë që ta sqaroj se në çfarë
7 konteksti është shkruar kjo deklaratë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
9 përgjigja juaj a është që "Po, kjo është një deklaratë që unë
10 e kam postuar". A po thoni që është një deklaratë që e keni
11 postuar ju?

12 DËSHMITARI: Sintezë e imja e një shkrimi më të gjerë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
14 ju lutem.

15 DËSHMITARI: Po është një deklaratë që kërkon sqarim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
17 është diçka që do ta shohim më vonë. Por fillimisht duam të na
18 thoni nëse është kjo një deklaratë e postuar prej jush. Kjo
19 është një pyetje që kërkon "po" ose "jo".

20 DËSHMITARI: Po.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

22 PY. A nuk është gjithë teksti këtu i asaj që keni postuar? Më
23 korrigjoni në qoftë se e kam gabim. A s'keni postuar vetëm
24 kaq, apo ka më shumë te postimi po që ne nuk e shohim dot?

25 PË. Shkrim që është botuar në shtyp, sinteza e atij shkrimi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 121

1 është këtu. Është shkrimi është më i gjerë që lidhet me

2 arsyetimin pse kam ardhur deri te ky konstatim.

3 PY. Po kaq keni postuar ju. Ju për audiencën vetëm kaq keni

4 postuar atë ditë apo jo?

5 PË. Shkrimi ka qenë i publikuar në të gjitha mediat në Kosovë

6 dhe prandaj nuk kam dashtë ta ngarkoj edhe ka qenë i publikuar

7 dhe atë shkrim mund ta dorëzoj të shifni. Megjithatë --

8 PY. E kuptojmë, por ama ju zgjodhët t'i jepnit vetëm kaq

9 audiencës. Ju vendosët, ju zgjodhët këtë tekst nga artikulli

10 juaj. Ju zgjodhët të postonit vetëm kaq apo jo?

11 PË. Pikërisht për këtë arsye kam nevojë për shpjegim. Se mund

12 të konsiderohet si vetëfajësi, që hymë edhe në rregullën

13 151(1) të Rregullores. E shkoqitur kështu kjo mund të shihet

14 sikur fajësoj vetveten për [e pakuptueshme].

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

16 falni, se po përpiqem ta kuptoj. Pse do të ishte ky

17 vetëfajësim, vetëinkriminim?

18 DËSHMITARI: Këtu futen domethënë në mënyrë qëndrimet

19 politike të mia.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

21 përgjigju pyetjes time, ju lutem.

22 DËSHMITARI: Juridike si ndërmarrje kriminale mund të

23 perceptohet si një gabim domethënë kam ba unë. Dhe praktikisht

24 duke e pohuar me një "po" ajo i bjen se unë vetëfajësohem.

25 Prandaj ka nevojë të sqarohet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 122

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
2 nuk shoh asnjë vetëinkriminim këtu sa i takon postimit tuaj.
3 Kështu që të jeni të sigurt që nuk do ta konsiderojmë kështu.
4 Mos u shqetësoni për këtë gjë fare.

5 Vazhdoni Prokuror

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdojmë.
7 Mbarova me këtë dokument dhe doja të shihnim një dokument
8 tjetër.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Vazhdoni

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është një intervistë që me sa
12 kujtoj, ja keni dhënë me 23 shkurt 2022 në një -- më falni--
13 në një emision televiziv RTK Prime e keni dhënë këtë. Ka qenë
14 një *Talk Show* që është RTK Prime më 23 shkurt 2022. Në qoftë
15 se kjo nuk ju thotë asgjë, unë mund t'ju tregoj një postim
16 tjetër që t'ju rifreskojë kujtesën.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa
18 kujtoj unë ka qenë një postim ku është përmendur kjo dhe ne
19 s'e kemi lejuar që të përdoret se nuk pamë asnjë lidhje.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë e kam përfshirë sidoqoftë
21 në rast se dëshmitari thotë që "Nuk më kujtohet". Po nëse
22 dëshmitari thotë që "Kam marrë pjesë në këtë *Talk Show*, në
23 këtë debat" atëherë nuk është nevoja që ta shfaqim. Po nëse
24 nuk i kujtohet mund ta shfaqim.

25 PY. Ju kujtohet pra të keni marrë pjesë në këtë debat

1 televiziv RTK Prime?

2 PË. Më kujtohet shumë mirë që kam marrë pjesë në këtë debat,
3 por nuk e di çfarë keni shkëputur nga ai debat. Nëse debati
4 është në tërësi, do të shifni domethënë se çështjet --
5 qëndrimet e mia. Nëse shkëputen thënie të caktuara nga
6 konteksti, mund të interpretohen gabimisht.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kam edhe një dokument tjetër
8 për të treguar dëshmitarit. Dhe do të përfundoj. Po thjesht
9 këtë po e them për Trupin Gjykses për të kuptuar sesa kohë do
10 të më nevojitet.

11 A mund të shfaqim në ekran materialin SPOE003411152-
12 00341158. Kjo është shqipja. Anglishtja është SPOE003411153-
13 SPOE003411156-ET.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Cili është
15 qëllimi i këtij dokumenti?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua t'i tregoj disa deklarata
17 që ka bërë gjatë këtij debati televiziv, për të na thënë nëse
18 janë të vërteta apo jo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull.

21 Vazhdoni.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, titulli i
23 këtij debati televiziv është Gjykata Speciale, anglisht
24 *Specialist Chambers*. Pra, Gjykata Speciale ka qenë tema e
25 këtij debati televiziv.

1 DËSHMITARI: Nuk e lexova. A mund të zmadhohet ju lutem.

2 Pjesën e parë.

3 PY. Po do të shkojmë, do të shkojmë. Nuk kemi shkuar te faqja
4 e duhur ende. Dhe dua të shihni këtu paragrafin e fundit. Në
5 anglisht thuhet -- në anglisht është faqja tjetër. Paragrafi i
6 fundit në të dyja versionet. Mendimi juaj është ky:

7 "Sot ta vendosësh luftën çlirimtare të Kosovës në bankën
8 e akuzës duke bërë përgjegjëse UÇK-në për krimet e sajua në
9 laboratorët e shërbimeve sekretare [Sipas përkthimit] Serbe
10 qëllimi veçse politik. Qëllimi është të ndëshkohet kjo luftë
11 dhe pikërisht të rishkruhet historia e saj ç'ka ka ndodhur në
12 Kosovë, në dëm të popullit shqiptar të saj dhe në dëm të
13 pavarësisë së Kosovës', tha Mahmuti."

14 Pyetja ime e parë, z. Mahmuti është kjo: Kjo është një
15 deklaratë që keni bërë ju pa lexuar asnjë prej aktgjykimeve
16 publike të lëshuara prej kësaj Gjykate.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
18 mirë pyeteni a e ka bërë këtë deklaratë.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

20 PY. Z. Mahmuti, a e keni bërë ju këtë deklaratë gjatë RTK
21 Live? E pastaj flasim -- por a janë këto komentet tuaja gjatë
22 atij debati televiziv dhe a janë reflektuar siç duhet në këtë
23 artikull?

24 PË. Po, i kam bërë, janë deklarata të sakta. Po siç thuhet
25 këtu, çdo gjë që është marrë si provë nga shërbimi sekret për

1 ta cilësuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si ndërmarrje e
2 përbashkët kriminale ka qenë e papranueshme sepse derisa shefi
3 i komisionit të Serbisë që i ka dorëzuar Prokurorisë prova
4 thotë "Ne i kemi orientuar në çfarë drejtimi të bëhen akuzat",
5 qëllimi është politik, të vehet ushtria çlirimtare dhe lufta
6 çlirimtare e popullit shqiptar të Kosovës në bankë të akuzës.
7 Atë qëndrim politik e kam pasur dhe atë qëndrim e ruaj.
8 PY. Në rregull. Faleminderit, z. Mahmuti. Tani nëse e kam
9 kuptuar siç duhet, ju keni bërë këtë deklaratë, por kur e keni
10 bërë këtë deklaratë, ju nuk i kishit lexuar aktgjykimet apo
11 aktakuzat, dokumentet gjyqësore të cilat janë publike dhe që
12 ka lëshuar kjo Gjykatë. Kështu? Nuk i keni lexuar këto që sapo
13 citova?

14 PË. Kam lexuar qëndrimet e shtetit serb që mburret me provat
15 që ua ka dhënë. Mu më ka mjaftuar të vij deri te ky qëndrim
16 politik.

17 PY. Faleminderit

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përfundova
19 me këtë dokument. Tani do të kalojmë te një dokument tjetër,
20 dokumenti i fundit.

21 Është një postim tjetër në Facebook i z. Mahmuti. Kam dy-
22 tri pyetje në lidhje me këtë. Së pari, sa i takon autorësisë
23 dhe kam dy-tre pyetje të tjera njësoj siç bëra me postimet e
24 mëparshme.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 126

1 vazhdoni

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] ERN-ja është SPOE00341144-
3 00341147 shqipja.

4 Anglishtja është SPOE00341144-SPOE00341145-AT, ET më
5 falni.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
7 të vazhdoni, por ndërkohë z. Prokuror qëllimi është të
8 autentikojmë këto postime.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të pyesim dëshmitarin. Kam disa
10 pyetje lidhur me postimin, çfarë ka dashur të thotë me postim,
11 ku e ka bazuar këtë postim. Edhe qëndrimin që ka aktualisht
12 lidhur me këtë postim.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 PY. Ky është postimi i fundit në Facebook për të cilin dua të
17 komentoni z. Mahmuti. Është një postim në Facebook ky. Mund ta
18 lexoni?

19 PË. Po.

20 PY. Ky ka datën 16 dhjetor 2022. Pikërisht këtë datë Dhomat e
21 Specializuara të Kosovës lëshuan aktgjykimin me anë të të
22 cilit shpallën fajton z. Salih Mustafa që është aktualisht në
23 apel. Dhe është dënuar për akuzën për ndalimin arbitrar,
24 torturë, vrasje të paligjshme të kryer ndaj shqiptarëve të
25 Kosovës. Mund të them që aktgjykimi është botuar për herë të

1 parë në janar. Pra, në këtë datë s'ishte ende publike, në
2 datën që keni bërë postimin.

3 Ju keni thënë kështu, citoj:

4 "Dënimi i padrejtë i Nasim Haradinajt, Hysni Gucatit dhe
5 Salih Mustafës dëshmon se Gjykata e krijuar mbi bazën e
6 sajësive politike nuk u bë për të hequr akuzat shpifëse ndaj
7 UÇK-së, por për ta vënë atë në bankën e akuzës dhe për ta
8 dënuar. Pa zhbërjen e kësaj sajese politike, nuk do të ketë
9 drejtësi".

10 I qëndroni kësaj deklaratë edhe sot e kësaj dite, z.
11 Mahmuti?

12 PË. I qëndroj dhe ka nevojë të shpjegohet siç kërkuat edhe
13 ju, z. Prokuror, të jap shpjegime.

14 Çështja e bindjeve të disa njerëzve në Kosovë se Gjykata
15 që do të krijohet, krijohet me qëllim që të ndriçohet
16 pafajësia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës -- atëherë kam qenë
17 kundër krijimit të UÇK-së -- të kësaj Gjykate, publikisht kam
18 bërë një apel drejtuar të gjithë deputetëve të kuvendit të
19 Kosovës. Kam dhënë qëndrimet e mia politike sepse një Gjykatë
20 kurrkund në botë nuk duhet të krijohet për të vërtetuar a
21 është fajtor dikush apo nuk është fajtor dikush. Gjykata duhet
22 të krijohet për të ndriçuar rastet e krimeve. Në Kosovë ka
23 pasë krime, ka pasë vrasje civilësh të të gjitha përkatësive
24 etnike ku shqiptarët kanë qenë mbi 10.000 vetë. Kjo duhet të
25 ndriçohet. Dhe një Gjykatë që ndriçon këtë rast është më se e

1 nevojshme.

2 Mirëpo, nga momenti ku nuk mirren përgjegjësit prej kreut
3 të shtetit, e kreut të shërbimit sekret i cili thotë "Kemi
4 vrarë aq shumë civilë të të gjitha përkatësive sa Serbia do të
5 gjunjëzohej [e pakuptueshme] asaj dëshmoje se cilët janë
6 civilët shërb, cilët janë civilët shqiptarë dhe përkatësive
7 etnike që janë vrarë [e pakuptueshme].

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
9 po përsëritni atë që e keni thënë më herët, Dëshmitar. Këtë e
10 dëgjuam. Nuk dua ta dëgjoj përsëri këtë sepse unë e kam të
11 qartë. Vetëm pak ndërpreni këtu sepse e shikoj sfondin e kësaj
12 deklarate. Nuk dua që ta përsëritim prapë sepse e kemi në
13 procesverbal

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
15 PY. Atëherë, si mund të thoni që akuzat janë shpifëse në
16 qoftë se nuk e keni lexuar arsyet për të cilat konsiderohen se
17 këto akuza janë të vërteta dhe ju kujtoj këtu që viktimat në
18 këtë gjykim kanë qenë shqiptarë të Kosovës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 [Mikrofoni çaktivizuar]

21 Z. Dëshmitar, përpara se t'i përgjigjeni pyetjes do t'ja
22 jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes. Urdhëroni, e keni fjalën z.
23 Avokat.

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

25 Kundërshtojmë pyetjen e Prokurorit ku i kërkon

1 dëshmitarit që të shfaqë opinionet politike të veta që i ka
2 shfaqur publikisht edhe nëpër debatet televizive dhe në media
3 të tjera. Ky zotëri ka qenë i përfshirë në punët publike,
4 nëpër debate televizive, nëpër postime në Facebook ku ka
5 postuar mendimet e veta. Këto pyetje iu bënë, mund ta lejojmë
6 që t'i përgjigjet sa i përket sfondit politik të këtyre
7 deklaratave, mirëpo nuk mund ta pyesim sesi ndiheni ju në
8 lidhje me këto opinione.

9 Këto janë kontributet personale politike të tij në lidhje
10 me ngjarjet publike të atij shteti.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
12 t'ju ndërpres këtu sepse në qoftë se ju kuptova drejtë, ju po
13 e kundërshtoni një pyetje -- që dëshmitarit t'i bëhet një
14 pyetje kur dëshmitari tashmë i është përgjigjur asaj pyetje.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk mendoj që iu përgjigj
16 dëshmitari pyetjes.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
18 kuptoj atë që po përpiqeni ta thoni.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk është pyetje t'i thuash
20 dëshmitarit "Si ndjehesh, a ndjehesh rehat në lidhje me këtë
21 që është thënë këtu?".

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Atëherë, do t'i kërkoj mbas këtij kundërshtimit tuaj
24 Prokurorit që ta riformulojë pyetjen e vet. Sepse e kuptoj
25 tani atë që do të thotë Mbrojtësi. Pyetja, të paktën ashtu

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 130

1 sikurse fillon, nuk është e qartë. Mund të jetë edhe më e
2 qartë.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, a nuk mendoni që nxjerrja e përfundimeve mbi
5 atë nëse akuzat kundër dikujt janë shpifëse, a nuk do të
6 ndihmonte që të ishin lexuar këto aktgjykime apo deklarata
7 dëshmitarësh që kanë dhënë dëshmi këtu para kësaj Gjykate,
8 përpara se të nxjerr një përfundim i tillë. A nuk do të
9 ndihmonin leximi i atyre dokumenteve në nxjerrjen e atyre
10 përfundimeve që i keni nxjerrë ju, sipas të cilat të gjitha
11 gjykimet dhe të gjitha aktgjykimet që i kemi diskutuar këtu
12 janë të bazuara në prova shpifëse?

13 PË. Fakti që sot unë ndodhem para kësaj Gjykate është një
14 dëshmi se unë ndaj pikëpamjet e mia politike nga çështja e
15 proceseve gjyqësore. Unë e pranoj procesin gjyqësor si proces
16 gjyqësor dhe kam ardhur të them atë që di dhe vetëm atë që di
17 lidhur me këtë proces. Nga momenti kur unë vij këtu dhe më
18 nxirren një numër qëndrimesh politike, unë çuditem sesi
19 Prokuroria e Specializuar asnjëherë nuk u distanca nga
20 qëndrimi i Milovan Dreçunit i cili thotë "Se nuk kanë ditë
21 ç'ka bëjnë, unë i kanë mësuar se ç'ka duhet të bëjmë dhe si
22 duhet të veprojnë ndaj UÇK-së". Asnjë distancim publik. Njeriu
23 që ka marrë dekoratë --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Dëshmitar, përsëri kjo nuk është përgjigje ndaj pyetjes që u

1 është bërë.

2 Z. Prokuror, nuk e di në qoftë se do të vazhdoni në
3 lidhje me këtë pyetje

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, dua të vazhdoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull, por atëherë, mundohuni që dëshmitari të përgjigjet
7 pyetjes suaj sepse unë shoh që ai nuk i përgjigjet pyetjes.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

9 PY. Opinionet që i keni shprehur mund të jenë politike, mund
10 të jenë opinione personale që i keni bërë publikisht në
11 Facebook, në profilin tuaj në Facebook dhe e keni bërë të
12 qartë sot se opinionet që i keni shprehur lidhur me proceset
13 para kësaj Gjykate, ato mendime i keni shprehur pa përfituar
14 nga dijenia apo njoftimi i juaj me dokumentet e nxjerra prej
15 kësaj Gjykate.

16 Pyetja ime është: A nuk mendoni ju se duhet të ishte më e
17 përshtatshme dhe do t'ju kishte ndihmuar që të nxirrnit një
18 përfundim më të besueshëm sikur t'i kishit lexuar aktgjykimet,
19 sikur t'i kishit lexuar ato që kanë thënë dëshmitarët
20 shqiptarë, kosovarë që kanë dëshmuar këtu përpara se t'i
21 quanit këto akuza të ngritura nga kjo Gjykatë "shpifëse,
22 politike dhe të krijuara nga serbët"?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbrojtësi thotë që nuk e kupton
24 fjalën "shpifëse". Ky është një mendim i dëshmitarit i dhënë
25 në një shprehje të lirë të fjalës. Ne mund të pajtohemi, të

1 mos të pajtohem me mendimin. Mirëpo "shpifëse", unë nuk di në
2 qoftë se ka ndonjë procedurë të paraqitjes së ankesës sepse
3 nuk e di në qoftë se është e përshtatshme që në anglishte të
4 përdoret fjala "deflatory" që do të thotë "shpifëse"

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Këtë fjalë e ka përdorur vetë
6 dëshmitari në postimin e vet në Facebook.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Avokat i Mbrojtjes, kjo është përgjigja për ju. Këtë fjalë e
9 ka përdorur vetë dëshmitari në postim.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 PY. Nëse më lejoni tani do ta bëj pyetjen time të fundit.

12 PË. Ju garantoj se sapo të më pretojë koha, do t'i lexoj të
13 gjitha proceset gjyqësore që janë publike, dhe do të jap
14 qëndrimin tim dhe do t'ju dëshmoj se mbi bazën e të cilëve
15 argumente janë sjellë [e pakuptueshme]. Pa i lexuar këto mbaj
16 qëndrimet e mia politike, si e drejtë e pakontestueshme që të
17 shpreh atë që mendoj.

18 PY. Ju faleminderit për durimin z. Dëshmitar.

19 Të nderuar Gjykatës, me kaq përfunduan pyetjet e mia për
20 dëshmitarin.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Prokuror.

23 Tani fjalën do t'ja jap meqë përfundam me kundërpjetet
24 e zyrës së Prokurorit të Specializuar, pra do t'ja jap fjalën
25 Mbrojtësit të Viktimave, Përfaqësuesit të Viktimave.

1 Z. Avokat mund të vazhdoni.

2 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

3 Z. LAWS: [Përkthim]

4 PY. Do të filloj duke i bërë pyetje këtij dëshmitari në
5 lidhje me një dokument dhe për arsye të dukshme nuk do të
6 kërkoj që ky dokument të vendoset në ekran. Por në qoftë se
7 kolegët nga Mbrojtja dhe paneli i Trupit Gjykues duan ta hapin
8 këtë dokument, është materiali 2 në listën e dokumenteve për
9 prezantim. Mban numrin ERN SITF00018740 deri në 00018767.
10 Është faqja 3 e dokumentit me numër SITF00018742.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
12 dokument a mund të diskutohet në seancë publike?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Thjesht dua të bëj disa pyetje të
14 shkurtra në lidhje me informacionin, një pjesë të
15 informacionit që paraqitet në këtë dokument.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Domethënë nuk doni që të vendoset në ekran ky dokument. Është
18 një qasje tjetër nga ato që i kemi përdorur deri tani. Thjesht
19 dua ta kem të qartë se çfarë keni ndërmjet të bëni.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Në qoftë se shikoni në atë faqe në
21 paragrafin e katërt fjala fillon me një emër - me një emër
22 dëshmitari, dhe ka pastaj ka informacion në lidhje me të. Dua
23 thjesht ta pyes dëshmitarin në qoftë se informacioni në fjalë
24 ka të bëjë me të. Thjesht dua që t'i jap mundësia që të
25 konfirmojë se çfarë kemi këtu në këtë dokument.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,
2 dëshmitarit nuk i lejohet që të shikojë dokumentin apo jo?

3 Z. LAWS: [Përkthim] Në qoftë se ja tregojmë dëshmitarit
4 dokumentin atëherë do të identifikohet edhe burimi i
5 informacionit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rregull. Mund të vazhdoni.

8 Z. LAWS: [Përkthim]

9 PY. Z. Mahmuti, vetëm pak informacion sfondi na duhet.
10 Mirëdita para së gjithashtu. Unë jam Përfaqësuesi i Viktimave
11 në këtë çështje dhe kam disa pyetje për ju.

12 PË. Ju dëgjoj. Mirëdita.

13 PY. Pyetja që do t'jua bëj së pari është një pyetje të cilës
14 mund t'i përgjigjeni me "po" ose "jo".

15 A keni formuar një parti politike në Maqedoni?

16 PË. Po.

17 PY. Faleminderit. Dhe kjo parti a është Unioni Demokratik i
18 Shqiptarëve?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe kjo parti u themelua në vitin 2007 nga ana juaj. A
21 është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 PY. Ju me prejardhje jeni nga Maqedonia, nga qyteti i
24 Tetovës. A është kjo e saktë?

25 PË. E saktë.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

2 mund t'i bëni pyetjet të tipit të hapur.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Sigurisht që po, por thjesht nuk
4 desha që ta ngatërroj me vendin e lindjes. Nuk është problem
5 do t'ia bëj pyetjet e drejtpërdrejtë.

6 PY. Dëshmitar, ku keni lindur, prej nga jeni?

7 PË. Jam i lindur në Tetovë.

8 PY. Faleminderit. Në dhjetëvjeçarin, në dekadën pas luftës, a
9 keni dalë në televizor në Kosovë në përgjithësi kështu?

10 PË. Kam qenë shumë shpesh, qoftë në mediat në Kosovë, qoftë
11 në mediat në Shqipëri, qoftë në mediat në Maqedoni.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Këto ishin pyetjet që desha t'i bëj
14 në lidhje me këtë dokument.

15 PY. Tani në vijim z. Mahmuti, dua t'ju bëj disa pyetje në
16 lidhje me Kukësin.

17 Na thatë dje - dhe kjo është në faqen 2514 të
18 transkriptit, rreshtat 20 dhe më tej na thatë që kishit shkuar
19 në Kukës në maj të vitit 1998. A ju kujtohet kjo përgjigje?

20 PË. Po.

21 PY. A mund t'ju pyes sesi ju kujtohet që ishte maj i vitit
22 1998? Çfarë ju çoi në Kukës?

23 PË. Kanë qenë çështje të mobilizimeve për luftën çlirimtare.
24 Më kujtohet maji se pikërisht në muajin maj të vitit 1998 më
25 është thënë që duhet të kthehem në Zvicër dhe të takohem me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Faqe 136

1 delegacionet amerikane. Dhe pikërisht në qershor të vitit 1998
2 kanë qenë takimet zyrtare. Ky fakt është ajo që më bën ta di
3 kohën kur kam qenë për herë të fundit në Kukës.

4 PY. Faleminderit. Gjatë asaj vizite në maj të vitit 1998, a
5 shkuat në një vend që njihej si fabrikë e metalit në Kukës?

6 PË. As që kam ditë që ka fabrikë metali në Kukës. Nuk kam
7 qenë asnjëherë në ndonjë vend që quhet fabrikë metali në
8 Kukës.

9 Z. LAWS: [Përkthim] A mund t'i tregojmë dëshmitarit disa
10 fotografi në lidhje me këtë objekt, të nderuar Gjykatës. Është
11 dokumenti me numër SPOE40020246 [sipas përkthimit] deri në
12 420559.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Shikoj që është ngritur Mbrojtësi në këmbë.

15 Urdhëroni z. Aouini.

16 Z. AOUINI: [Përkthim] A mund të na thoni Avokat se mbi
17 çfarë baze i tregohet ky dokument dëshmitarit dhe për çfarë
18 qëllimi.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam në duart e tuaja, të nderuar
20 Gjykatës. Unë thjesht po e pyes dëshmitarin në goftë se ka
21 dijeni për një objekt të njohur si fabrikë e metalit në Kukës
22 dhe dua që për këtë t'i tregoj dëshmitarit disa fotografi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta
24 nxjerrim një herë dëshmitarin nga salla.

25 Dëshmitar, do të duhet të dilni nga salla për disa

1 minuta.

2 [Dëshmitari përfundon dëshmi]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Avokat. Më falni desha të thosha Mbrojtësi i Viktimave.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Dëshmitari thotë që ka qenë në Kukës
6 në maj 1998 edhe sikurse e di edhe Trupi Gjykues na e
7 intereson periudha e majit 1998 po ama ka qenë në qytetin që
8 na intereson dhe dua ta pyes a ka shkuar në vendndodhjen që na
9 intereson ne. Ai u përgjigj "Jo, as që kam pasur dijeni". Unë
10 dua që të mos kemi paqartësi, që nuk kemi keqkuptime. Prandaj
11 do t'i tregoj disa fotografi që mund ta ndihmojë t'i kujtohet
12 në qoftë se ka qenë apo jo në këtë vend. Nëse thotë që prapë
13 nuk kam qenë, okej, në rregull atëherë.

14 Po mua më duket krejt legjitime që ta bëj këtë pyetje dhe
15 këtë gjë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
17 dëgjova arsyetimin tuaj. Dhe mua më duket krejt normale dhe
18 krejt legjitime.

19 Sekretare mund ta sillni sërish dëshmitarin në sallën e
20 gjyqit.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
23 se erdhët, z. Mahmuti.

24 Vazhdoni Mbrojtësi i Viktimave.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Do ta përsëris edhe një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Faqe 138

1 herë numrin e provës, numrin e fotografive. SPOE40010264 deri
2 në 0010559. Ju lutem të vendoset fotografia e parë në ekran.
3 PY. Dëshmitar, do t'ju tregoj disa fotografi e të shohim nëse
4 ju ndihmon me kujtesën.

5 Kjo është një fotografi nga brenda objektit që është
6 fabrika e metalit, përmes këtyre portave të hekurit. A e
7 shihni portën e hekurit dhe rrugën pas portën?

8 PË. E shoh portën e hekurit edhe rrugën pas portës.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Shohim fotografinë tjetër.

11 PY. Këtu jemi më në brendësi të zonës që dikur ka qenë
12 fabrika e metalit. Keni qenë ndonjëherë në këtë vendndodhje,
13 z. Mahmuti, në këtë vend.

14 PË. Të sqaroj. Në Kukës kam mbërri në mbrëmje vonë. Atë natë
15 më është bërë e ditur që duhet të kthehem në Tiranë pa asnjë
16 sqarim. Më ka thërrit Xhavit Haliti. Kur kam mbërri, jam nisur
17 në mëngjes kemi qenë të vendosur në një shtëpi në Kukës. Në
18 mëngjes jam nisur me një kombi, kam qenë i vetëm edhe kam
19 mbërri në Tiranë. Në Tiranë më është thënë që duhet të kthehem
20 në Zvicër ku do të takohem me delegacionin amerikan. As kam
21 parë një ndërtesë të tillë, as rrugën që më përshkruat. Mund
22 të më nxirrni fotografi ju sigurt që asnjëherë këmba ime nuk
23 ka shkelur në këto vende, pos në një shtëpi ku kam fjetur atë
24 natë.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Ju lutem, të shohim fotografinë

1 tjetër. Fotografinë tjetër. Prapë fotografinë tjetër,
2 fotografinë e radhës. Besoj se është edhe një tjetër. Ju lutem
3 edhe një tjetër.

4 PY. Në rregull. Kjo -- ky objekt a ju thotë gjë, a është i
5 njohur për ju?

6 PË. U përgjigja që gjatë qëndrimit tim në Kukës nuk kam parë
7 asnjë objekt. Kemi mbërri vonë kam fjetur atë natë dhe jam
8 kthyer të nesërmen. Kam udhëtuar gjithë ditën në mbrëmje. Në
9 mbrëmje jam takuar me Xhavit Halitin, dhe më është caktuar të
10 udhëheq pasqyrimin dhe prezantimin e platformës politike të
11 Ushtria Çlirimtare e Kosovës pranë delegacionit amerikan.

12 PY. Faleminderit. A kujtohet si udhëtuat drejt Shqipëri, atë
13 rast, në maj 1998, me çfarë udhëtuat, si udhëtuat?

14 PË. Nuk më kujtohet saktësisht.

15 PY. A udhëtuat me avion nga aeroporti i Rinasit, me traget
16 nga Durrësit, apo me ndonjë mjet tjetër udhëtimi, në ç'formë
17 pra?

18 PË. Nuk më kujtohet. Pra ka pasur dy mundësi qoftë përmes
19 trenit deri në Bari. Nga Bari në Durrës. Qoftë përmes
20 udhëtimit nëpërmjet aeroplanit nga Zyrihu në Tiranë. Nuk më
21 kujtohet saktësisht dhe nuk mund të jap përgjigje sepse nuk e
22 kam menduar ndoshta duke hulumtuar do të më fillohet mënyra
23 sesi kam udhëtuar në atë kohë, por nuk më kujtohet
24 absolutisht.

25 PY. E kuptoj këtë gjë.

1 PË. Nëse ju intereson si kam udhëtuar nga Tirana në Kukës
2 mund t'ju tregoj se rrugët kanë qenë shumë të këqija dhe kemi
3 bë 16 orë --

4 PY. Jo, nuk më intereson kjo. Jo kjo pjesë. Të jeni i sigurt
5 që nuk më intereson. Do ju kisha pyetur. Ajo që më intereson
6 është udhëtimi i majit 1998 për të cilin na treguat.

7 Pasaportën ja u kanë vulosur gjithmonë sa herë keni hyrë në
8 Shqipëri. Vulosej çdo herë pasaporta?

9 PË. Sa di unë, po. Vetëm nuk do të thotë -- dua të sqaroj një
10 gjë. Më pyetët kur kam qenë në Kukës. Jo kur kam ardhur në
11 Shqipëri. Se në Shqipëri kam mund të shkoj në muajin prill e
12 në Kukës të shkoj në muajin maj. Në qoftë se domethënë, të
13 jenë gjërat të qarta. Për në Kukës kam qenë në muajin maj.

14 PY. Po. Unë thjesht po ju pyesja, pasaportën jua vulosnin çdo
15 herë që hynit në Shqipëri? Këtë dua të kuptoj me "po" ose me
16 "jo" apo edhe "nuk e di".

17 PË. Me dijeni time çdo herë që kam hyrë ose që kam dalë është
18 vulosur pasaporta.

19 PY. Në kohën e luftës njerëzit kalonin kufirin drejt
20 Shqipërisë pa kaluar përmes pikës kufitare? Ndodhte që ta
21 kalonin kufirin ka kaluar përmes pikës së kontrollit kufitar?

22 PË. Nga shtetet perëndimore për në Shqipëri, jo, se ka qenë
23 deti në mes.

24 PY. Po -- jo e di që ka një det, e di që është deti në mes.

25 Po nga Kosova, nga Kosova për në Shqipëri, edhe anasjelltas,

1 nga Shqipëria për në Kosovë? Në atë kohë a bëhej ndonjë herë,
2 a kalonin ndonjëherë kufirin por jo përmes pikës së kontrollit
3 kufitar, po në vende të tjera?

4 PË. Jeni duke më pyetur diçka për të cilën unë nuk kam asnjë
5 të dhënë dhe forma sesi kanë hyrë të tjerët dhe si kanë dalë
6 të tjerët. Personalisht nuk kam hyrë dhe nuk kam dalë.

7 PY. Vërtetë s'e dini në qoftë se UÇK-ja ka kaluar nga Kosova
8 drejt Shqipërisë apo nga Shqipëria për në Kosovë në rrugë që
9 të mos zbuloheshin? Këtë po thoni nën betim që nuk e dini?

10 PË. Jo, nuk e thashë një gjë të tillë. Nëse më kërkohet
11 konkretisht ta them a ka kaluar Bardhyli apo iksi apo ipsiloni
12 këtë nuk e di. Po dihet publikisht se krejt armatimi që ka
13 hyrë në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës ka kaluar
14 jashtë kufijve, nuk kanë shku nëpër doganat matanë kufinit që
15 të kalojnë me armatim. Çështje [e pakuptueshme] po në qoftë se
16 më pyesni konkretisht për të cilën mund t'ju them në qoftë se
17 iksi ose ipsiloni ka ba një punë të tillë.

18 PY. A kalohej rregullisht ai kufi nga persona të tjerë? Nuk
19 po flasim për ju personalisht, por pjesëtarë të tjerë të UÇK-
20 së, e kalonin atë kufi në mënyrë klandestinë apo jo?

21 PË. Në mënyrë të përgjithësuar përgjigja është "po" në mënyrë
22 konkrete si është zhvilluar atë nuk mund t'ju them se nuk e
23 kam bërë një gjë të tillë.

24 PY. Dua të flasim tani për vitin 1999.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 [Mikrofoni çaktivizuar]

2 Z. LAWS: [Përkthim] Mund të heqim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem hiqni fotografinë nga ekrani.

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. Në prill të 1999-s ju keni qenë në Shqipëri apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Më vonë gjatë atij viti, më vonë gjatë vitit 1999 keni
9 shkuar sërish në Shqipëri, por jo në Kukës?

10 PË. Më vonë deri në cilën periudhë se viti 1999 është prej
11 majit deri në 31 dhjetor?

12 PY. Po. A keni shkuar për pjesën tjetër të 1999-s, gjithë
13 pjesën e mbetur të 1999-s a shkuat më në Shqipëri? Pra, pas
14 prillit a shkuat më në Shqipëri?

15 PË. Në Shqipëri kam shkuar në qershor dhe pas përfundimit të
16 luftës, pej Shqipërie kam shkuar në Prishtinë. Kam shkuar disa
17 herë në Shqipëri pas përfundimit të luftës në cilësinë e
18 Ministrisë të Punëve të Jashtme të Qeverisë së Përkohshme të
19 Kosovës. Nuk më kujtohen datat saktësisht kur kam qenë. Ato
20 mund të verifikohen se kanë takime zyrtare në nivel të
21 presidentit, në nivelit të kryeministrit, të kryetarit të
22 kuvendit dhe të përfaqësuesve politikë.

23 PY. Gjatë kohës që ishit në Shqipëri, në prill dhe në qershor
24 1999 ishit ju në dijeni se UÇK-ja kishte një bazë në Kukës?

25 PË. Kur kam shkuar në Shqipëri kam shkuar në cilësinë e

1 anëtarit të kryesisë së Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në
2 Shqipëri nuk kam shkuar si përfaqësues i Ushtrisë Çlirimtare
3 të Kosovës se në Shqipëri ka qenë Xhavit Haliti i cili ka
4 përfaqësuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

5 PY. Z. Mahmuti, më kuptoni, nuk ishte kjo pyetje që ju bëra
6 unë. Doni që t'jua përsëris edhe një herë. Edhe mund t'i
7 përgjigjeni nëse doni me "po" ose me "jo". Pra, kur shkuat në
8 Shqipëri në prill ose në qershor të vitit 1999 a kishit ju
9 dijeni se UÇK-ja kishte një bazë në Kukës?

10 PË. Unë nuk kam pasur asnjë dijeni rreth organizimit të UÇK-
11 së në Shqipëri sesi kanë shkuar furnizimi me armatim, sepse ka
12 qenë një çështje që nuk më ka takuar mua, për arsye të
13 konfidencialitetit sepse ka qenë çështje e përgjegjësisë së
14 madhe që mos të dihet sesi hyhet armatimi, si bëhet armatimi.
15 Asnjëherë nuk jam interesuar rreth çështjeve që nuk më kanë
16 takuar mua. Përgjigja është: Nuk di asgjë lidhur me as
17 ekzistimin e bazave, as ekzistimin e strukturave mobilizuese
18 në Shqipëri.

19 PY. Pra, ju po thoni se nuk keni pasur fare asnjë ide që UÇK-
20 ja të kishte ngritur një bazë në Kukës, kështu?

21 PË. Saktësisht.

22 PY. Mirë. Kam edhe temën tjetër. Do të doja që të më lejonin
23 pak kohë sepse kam nevojë për pak kohë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Mikrofoni
25 çaktivizuar] Jo, nuk kemi mundësi sot më, Mbrojtësi i

1 Viktimave të zgjasim pas orarit zyrtar nëse nuk e mbyllni dot.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Do të përpiqem.

3 PY. Z. Mahmuti, unë jam këtu Mbrojtësi i Viktimave, në këtë
4 çështje gjyqësore. Besoj se e kuptoni që ky është roli im.

5 PË. Shumë mirë.

6 PY. Sipas jush ju po thoni "Nuk ka viktima në këtë çështje
7 gjyqësore", kjo është pikëpamja juaj?

8 PË. Jo, jemi keqkuptuar. Viktima civile ka. Shumë madje ka.

9 Çështja qëndron kush i ka vrarë. Janë prova të pakontestueshme
10 që ka njerëz me emrin Nazim Bllaca që ka qenë i urdhëruar nga
11 shërbimi sekret të vrasë shqiptarë e serbë e të tjerë. Është
12 Slavko Nikiç, në uniformë të UÇK-së që ka vrarë që ka bërë
13 edhe ai e pohon edhe në kopertinë të librit të vet, ka vu
14 fotografinë me uniformë të UÇK-së.

15 Janë dëshmi të tjera të civilëve të vrarë nga të gjitha
16 viktimat duhet të mbrohen. Të gjitha viktimat kanë nevojë për
17 drejtësi dhe për të përgëzoi të gjithë avokatët që mbrojnë
18 viktimat. Po është çështja të gjindet fajtori që ka shkaktuar
19 këtë tragjedi.

20 PY. Pra, a e kuptoj siç duhet që ju po thoni dhe ju besoni se
21 personat janë dëmtuar në Kukës janë lënduar në Kukës por këtë
22 e kanë bërë serbët? Këtë po thoni ju?

23 PË. Për persona në Kukës kam unë bindjen që janë sajesa të
24 shërbimeve sekrete serbe. Është deklarata publike e njeriut që
25 ka dorëzuar dosjet në Prokurorinë Speciale i cili pohon se ne

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Faqe 145

1 ua kemi dhënë emrat e 600 të mbajtjes në Shqipërinë veriore.
2 Nuk i përmend qendrat emër për emër por e merr në tërësi të
3 gjashtë qendrat vijnë nga shërbimi sekret.

4 Z. LAWS: [Përkthim] T'ju ndërpres.

5 PY. Dëshmitar, i ke thënë disa herë tashmë këto gjëra. Unë po
6 bëj një pyetje shumë konkrete.

7 Pra, ju po thoni që jeni i mendimit që ka pasur viktima,
8 por që këto viktima i kanë shkaktuar serbët. Kështu?

9 PË. Flas për viktimat në Kosovë. Për sajemat jashtë Kosove --

10 PY. Flasim për viktimat në Kosovë. Nuk po ju pyes për
11 viktimat në Kosovë. Po ju pyes se mbase nuk është e qartë, po
12 ju pyes konkretisht për Kukësin. Pra, a besoni ju, ju jeni i
13 besimit siç thatë këtu në bankën e dëshmitarëve po thoni që
14 "Po, ka viktima po janë serbët ata që i kanë kryer krimet
15 kundër tyre"?

16 Mund të përgjigjeni ju lutem me "po" ose me "jo".

17 PË. Unë u përgjigja që për në Kukës nuk besoj absolutikisht
18 se ka viktima nga ana [e pakuptueshme]. Krejt është sajese e
19 shërbimit sekret serb. Kjo është pikëpamja ime.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Nëse nuk keni përfunduar duhet ta mbyllim tani. Do ju
22 lejoj edhe një minutë.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Kam edhe një pyetje. A mund ta bëj
24 edhe këtë pyetje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

1 që është çuar edhe avokati. U ul avokati.

2 Z. LAWS: [Përkthim]

3 PY. Z. Mahmuti, a besoni që mbasi të keni mbyllur sytë ndaj
4 të vërtetës, a ka mundësi që t'i keni mbyllur sytë përballë të
5 vërtetës?

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Rrëzohet.

9 DËSHMITARI: Mund të përgjigjem?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
11 mund t'i përgjigjeni, mund të përgjigjeni.

12 DËSHMITARI: Betohe më sikur të kisha pasur dyshimin më
13 të vogël të përfshirjes së Pjetër Shalës në ndonjë krim, nuk
14 do të kisha ardhur të dëshmoja. Kam ndërgjegjen e pastër se
15 është i pafajshëm. Prandaj për sajemat e shërbimeve sekrete që
16 janë ba, kam ardhur të dëshmoj me dëshmi nga pala serbe nga
17 njeriu që thotë "Unë jam kam dhënë Prokurorisë dëshmitë dhe
18 provat". Provat që i kanë sajuar shërbimet e tyre. Prandaj kam
19 ardhur. Nuk do të vija, jo për Pjetër Shalën, për asnjë njeri
20 në botë sepse unë jam viktimë e një regjimi të mëparshëm.
21 Babai im ka qenë viktimë e një regjimi të mëparshëm, dhe e di
22 ç'ka do të thotë viktimë, e di ç'ka do të thotë i keqtrajtuar.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Ndalojmë këtu.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Kaq pyetje kisha. Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Faqe 147

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Avokat, doni të keni round tjetër.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi nevojë për një round
4 tjetër, pyetje shtesë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Atëherë --

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Mahmuti, përfunduar me dëshminë tuaj. Ju falënderoj për
10 dëshminë tuaj këto dy ditë. Faleminderit për përpjekjet tuaja.
11 Besoj se do të na ndihmojë që të dalim me një vendim.
12 Faleminderit.

13 DËSHMITARI: Faleminderit shumë. Falënderoj Trupin Gjykses
14 që më dha këtë mundësi të shpaloj një pjesë të asaj që di.
15 Edhe ajo që më mbetet, sidomos në kuadër të seancave të
16 mbyllura mbetet këtu, nuk do të shkojë.

17 Ju faleminderit shumë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
19 lutem, ju lutem. Vendosni pak dëgjueset. Dua t'ju kujtoj që
20 nuk duhet të diskutoni dëshminë tuaj që keni dhënë përpara
21 Dhomave të Specializuara me askënd. Tani Asistentja do t'ju
22 ndihmojë të dilni nga salla e gjyqit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka
25 gjë që dëshiron të parashtrojë ZPS-ja me Trupin Gjykses

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo. Vetëm një koment të
2 shkurtër. Unë në asnjë moment nuk e vura në dyshim
3 profesionalizimin e avokatëve. Ne kemi bashkëpunuar për një
4 kohë të gjatë. Kemi pasur të frytshëm bashkëpunimin edhe unë
5 nuk kam fare dyshim për profesionalizimin -- profesionalizmin
6 e tyre. Dua ta them këtë për procesverbal. Asnjëherë s'kemi
7 vënë në dyshim profesionalizmin e tyre në këtë sallë gjyqi.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Mbrojtësi i Viktimave.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

13 Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Seanca mbyllet këtu. Do të takohemi javën e 2 tetorit ku kemi
16 dy dëshmitarë, pra, atë javë.

17 Falënderoj stenografen e cila u përpoq shumë sot,
18 përkthyesit dhe gjithë të tjerët.

19 Seanca mbyllet këtu.

20 --- Seanca mbyllet në orën 16.05

21

22

23

24

25